



Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ Prishtinë/Priština, Kosovo | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

Raporti vjetor 2009



Parathënie

Ky është raporti i dytë vjetor i Panelit Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut (më tutje në tekst "Paneli"), përmes të cilit mbulohen veprimtaritë e Panelit gjatë vitit 2009.

Në vitin 2009, u bë e dukshme se UNMIK-u nuk kishte marrë parasysh në hollësi të gjitha pasojat që mund të vijnë nga themelimi i Panelit në vitin 2005-2006 me rastin e formulimit të konceptit, të bazës ligjore dhe të aspekteve organizative, ashtu siç është paraparë me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut. Rregullorja i referohet natyrës së Panelit, shkallës së pavarësisë së tij dhe procedurave për shqyrtimin e ankesave. Përveç kësaj, UNMIK-u nuk ka vlerësuar plotësisht nevojat thelbësore praktike të Panelit dhe, si rezultat, nuk ka dhënë numrin e duhur të punonjësve administrativë, numrin e kërkuar të juristëve, etj. Pasojat negative të këtyre mangësive që u bënë evidente që nga fillimi i punës së Panelit, gjegjësisht që nga fillimi i vjeshtës së vitit 2007, që u përshkruan në raportin e tij të parë vjetor për vitin 2008, dolën edhe më shumë në pah gjatë vitit 2009. Deri në atë kohë, e posaçërisht në gjysmën e parë të vitit 2009, numri i lëndëve po rritej me shpejtësi të madhe. Numri i vogël i punonjësve të Sekretarisë dhe vet Paneli nuk ishin në gjendje të ballafaqohen në mënyrë adekuate me numrin e lëndëve. Çështjet u ndërlikuan edhe më shumë nga fillimi i shqyrtimit substancial të lëndëve nga ana e Panelit, të cilat përfshinin çështje që, për arsye të ndryshme, janë delikate dhe të vështira.

Njëkohësisht, viti 2009 ka qenë vit i përpjekjeve të intensifikuara të anëtarëve të Panelit dhe të Sekretarisë së tij për të arritur përparime në trajtimin e sa më shumë lëndëve që ishte e mundur, pavarësisht nga pengesat e lartpërmendura. Megjithatë, kjo ishte edhe periudhë e tensioneve të vazhdueshme në marrëdhëniet e tij me UNMIK-un, që kryesisht kishin të bënin me interpretime të ndryshme të aspekteve të shumta të rëndësishme lidhur me natyrën e Panelit, me rolin e tij dhe me procedurat. Me kalimin e kohës, gjendja u bë temë e diskutimeve të tejkujtura brenda Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Institucione dhe organizata të ndryshme të përfshira në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë publikisht kanë shprehur shqetësimet e tyre lidhur me aspektet e caktuara të gjendjes së Panelit, duke përfshirë Komisionerin për të drejta të njeriut të Këshillit të Evropës, Amnesty International dhe Human Rights Watch.

Përmes Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, të nxjerrë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm më 17 tetor 2009, u bënë ndryshime që dukshëm kufizuan rolin e Panelit dhe mënyrën e funksionimit të tij. Edhe pse qëllimi i tij i deklaruar ka qenë vetëm interpretimi i disa dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Rregullorja e lartpërmendur në fakt është ndryshuar. Paneli nuk i ka mirëpritur këto ndryshime, dhe madje edhe i ka kritikuar gjatë fazës së konsultimeve. Sidoqoftë, Paneli shpreson se korniza e re rregulluese do t'ia mundësojë kryerjen e veprimtarive të tij në një klimë më të shtendosur.

Një pengesë tjetër serioze në veprimtaritë e Panelit gjatë vitit 2009 ishte periudha e gjatë deri në emërimin e anëtarit që do ta zëvendësonte znj. Snezhana Botusharova, e cila dha dorëheqje në qershor 2009, për t'u bërë anëtare e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Emërimi i pasueses së saj znj. Christine Chinkin, më në fund u bë në mesin e janarit 2010, dhe ajo dha betimin në mes të shkurtit 2010. Në ndërkohë Paneli nuk

ka mundur të bëjë ndonjë përcaktim lidhur me pranueshmërinë apo bazueshmërinë e ankesave.

Sido që të jetë, gjatë kësaj periudhe janë përgatitur lëndë të shumta për marrjen e vendimeve apo për dhënien e mendimeve përmes procedurave që shpesh ishin të ndërlikuara dhe kundërshtuese, të cilat përfshinin ankuesit dhe UNMIK-un, e nganjëherë edhe institucionet tjera. Është me rëndësi të theksohet se njëra nga detyrat më të vështira që me sukses u realizua nga Paneli dhe Sekretaria gjatë kësaj periudhe ishte elaborimi i procedurave dhe metodave të trajtimit të lëndëve të dërguara pranë Panelit në pranverë të vitit 2009, të cilat ndërlidheshin me pretendimet për mungesën e hetimeve të duhura dhe të efektshme të UNMIK-ut lidhur me zhdukjen e dhunshme apo vdekjet në Kosovë gjatë periudhave të ndryshme në vitin 1998. Këto lëndë aktualisht paraqesin grupin më të madh të çështjeve që presin shqyrtimin nga Paneli.

Përkundër të gjitha këtyre vështirësive dhe problemeve, me të cilat u ballafaqua në vitin 2009, Paneli është i përkushtuar që t'i përmbushë pritjet e tij si një instrument i rëndësishëm që është për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe si një model për misionet e ngjashme të OKB-së apo misionet tjera në pjesë të ndryshme të botës.

Marek Nowicki
Kryesues
Paneli Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut
Mars 2010

1. Hyrje

1. Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli), i themeluar përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të datës 23 mars 2006¹, ka vazhduar shqyrtimin e ankesave për shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) apo ato që i atribuohen atij gjatë vitit të dytë të funksionimit të tij në Prishtinë, Kosovë. Paneli mbetet mekanizimi i vetëm që merret me shkeljet e të drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga misioni në terren i Kombeve të Bashkuara apo që i atribuohen atij. Në dritën e këtij roli të veçantë, gjatë vitit 2009 Paneli vazhdoi të ballafaqohet me sfida të reja.

2. Në këtë raport vjetor mbulohet periudha prej 1 janarit 2009 deri më 31 dhjetor 2009, gjatë së cilës Paneli ka mbajtur 11 seanca, ka pranuar treqind e pesëdhjetë e një ankesa të reja², dhe ia ka komunikuar 71 raste Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në mënyrë që ai të jep komente për pranueshmërinë dhe/apo për bazueshmërinë e ankesave. Gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2009³, Paneli miratoi një mendim të pjesshëm për bazueshmëri, konstatoi 11 ankesa si të pranueshme apo të pranueshme pjesërisht, tetë ankesa i konsideroi si të papranueshme dhe refuzoi tri ankesa nga lista. Numri relativisht i ulët i vendimeve për ankesat duhet të shihet në dritën e kufizimeve praktike, me të cilat u ballafaqua Paneli gjatë vitit 2009, të cilat janë paraqitur si në vijim:

3. Pas dhënies së dorëheqjes së njëres prej anëtarëve të Panelit në qershor të vitit 2009, e cila pranoi postin e gjyqtare ndërkombëtare në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, Paneli mbeti me vetëm dy anëtarë gjatë tërë pjesës së mbetur të vitit. Me shpalljen e Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut, të datës 17 tetor 2009⁴ (e cekur më poshtë), Paneli më nuk ishte në gjendje të merr vendime për ankesat pas dhënies së dorëheqjes së njëres prej anëtarëve të tij deri në emërimin e anëtarit të tretë të Panelit.⁵

4. Njëkohësisht, për shkak të zvogëlimit të misionit të UNMIK-ut, gjatë vitit 2009 Sekretaria e Panelit përjetoj ndryshime rrënjësore në përbërje të saj. Numri i punonjësve ra prej dhjetë, sa ishin në maj 2009, në katër, në fund të qershorit 2009, gjegjësisht në dy zyrtarë ligjorë dhe dy asistente administrative. Derisa Sekretaria vazhdon me përpunimin e lëndëve dhe me përgatitjen e tyre për Panel, çrregullimi i

¹ Bashkëngjitur si shtojcë A.

² Vlen të ceket se për shkak të numrit të vogël të përkthyesve në UNMIK, deri në fund të vitit 2009, përfaqësuesit 123 ankesa kanë mbetur të papërkthyer dhe, rrjedhimisht, Paneli nuk ka mundur t'i shqyrtojë ato.

³ Shih diskutimin e Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejta të Njeriut, *infra*.

⁴ Bashkëngjitur si shtojcë B.

⁵ Neni 3.2 i Urdhresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1.

shkaktuar nga ndryshimet legislative dhe nga rënia e numrit të punonjësve ka kufizuar deklaratat publike të Panelit, duke filluar nga korriku 2009 e tutje. Në fillim të vitit 2010, Paneli u plotësua përsëri, në mënyrë që të jetë i gatshëm të vazhdojë me marrjen e vendimeve për shumë pretendime mbi shkeljet e të drejtave të njeriut, të parashtruara deri në fund të vitit 2009.

2. Përbërja e Panelit

2.1. Anëtarët e Panelit

5. Tre anëtarët të Panelit që punojnë me orar jo të plotë, të cilët janë emëruar nga kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut dhe janë riemëruar nga PSSP-ja në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/11, duke filluar nga 1 janari 2009 ishin: z. Marek Nowicki (Poloni), z. Paul Lemmens (Belgjikë) dhe znj. Snezhana Botusharova (Bullgari). Në janar të vitit 2008, Paneli zgjodhi z. Marek Nowicki si kryesues dhe e rizgjodhi atë në po të njëjtën pozitë në vitin 2009⁶.

6. Znj. Snezhana Botusharova dha dorëheqje nga Paneli më 15 qershor 2009, për të marrë postin e gjyqtare ndërkombëtare në Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

7. Më tutje në tekst janë dhënë të dhënat biografike të anëtarëve të Panelit.

8. **Marek A. Nowicki** (janar 2007 – vazhdon) është shtetas i Polonisë dhe jurist i fushës së të drejtave të njeriut. Që nga viti 1987 është anëtar i Odës së Avokatëve të Varshavës.

9. Z. Nowicki ishte Avokati ndërkombëtar i Popullit në Kosovë, i emëruar nga Kombet e Bashkuara nga korriku i vitit 2000 deri në dhjetor 2005. Ai ka qenë anëtar i Komisionit evropian për të drejta të njeriut në Strasburg nga marsi 1993 deri më 31 tetor 1999, dhe po ashtu ka qenë anëtar i Rrjetit të Bashkimit Evropian të ekspertëve të pavarur për të drejtat themelore, nga marsi 2003 deri në shtator 2006. Në vitin 2005 ai është emëruar nga Komisioni i ministrave si njëri prej kandidatëve për postin e Komisionerit për të drejta të njeriut të Këshillit të Evropës.

10. Ai ishte njëri nga juristët eminentë të emëruar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës për të vlerësuar gjendjen ligjore dhe atë të të drejtave të njeriut në Moldavi (1994) dhe në Azerbejxhan (1997). Në vitin 1996 dhe 1998, Këshilli i Evropës i ka propozuar të shërbejë si eksperti i të drejtave të njeriut gjatë vlerësimit të përputhshmërisë së sistemit ligjor të Gjeorgjisë dhe të Federatës Ruse me standardet e Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Ai ka punuar si ekspert i të drejtave të njeriut për Komisionin evropian për demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe për Drejtorinë e përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe çështjet ligjore të Këshillit të Evropës.

11. Ai ka qenë një ndër themeluesit e Fondacionit të Helsinkit për të drejta të njeriut në Varshavë dhe kryetar i tij prej nëntorit 2003 deri në shkurt 2008. Ai ishte anëtar i Këshillit këshillëdhënës të Qendrës ndërkombëtare për mbrojtje ligjore të të drejtave të

⁶ Rregullorja e Punës së PKDNJ (HRAP), Rregulla 6.

njeriut në Londër (INTERRIGHTS). Z. Nowicki është autor i disa librave dhe i qindra artikujve për të drejtat e njeriut, të botuara në Poloni dhe në vendet e tjera. Ai gjithashtu mban ligjërata për të drejtat e njeriut në universitetin “Collegium Civitas” në Varshavë.

12. **Paul Lemmens** (janar 2007- vazhdon) është shtetas i Belgjikës dhe gjyqtar në Këshillin e shtetit të Belgjikës, post ky që e ka mbajtur që nga viti 1994. Ai ka shërbyer në sektorin e Këshillit të shtetit që shqyrton përputhshmërinë e propozimlegjislaturës dhe propozimrregulloreve me normat më të larta të së drejtës vendore dhe ndërkombëtare, si dhe në sektorin e së drejtës kontestimore të Këshillit të shtetit, e cila përbën Gjykatën Supreme Administrative të Belgjikës.

13. Që nga viti 1986, z. Lemmens po ashtu ka qenë profesor në Universitetin e Leuvenit, ku ligjëron të drejtën ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Ai gjithashtu ka ligjësuar të drejtën kushtetuese, procedurën civile dhe atë administrative. Po kështu, ai është autor i një numri librash dhe artikujsh për ligjet evropiane për të drejta të njeriut. Ai është drejtor belg i Programit evropian të magistraturës për të drejta të njeriut dhe demokratizim, Program ky evropian ndëruniversitar me bazë në Venedik të Italisë. Z. Lemmens ka qenë anëtar i Komisioni të Belgjikës për mbrojtjen e të dhënave prej vitit 1987 deri në vitin 1997 dhe gjithashtu është anëtar i Komisionit shtetëror për të drejtat e fëmijës që nga viti 2007. Ai ka qenë ekspert i Këshillit të Evropës për studimin e përputhshmërisë të disa sistemeve shtetërore (të shteteve të Evropës qendrore dhe lindore) me Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut gjatë viteve 1990-ta. Tani ai është eksperti i lartë i Belgjikës në grupin ligjor të ekspertëve të Agjencisë së Bashkimit Evropian për të Drejta Themelore (FRALEX).

14. **Snezhana Botusharova** (maj 2008-qershor 2009) është shtetase e Bullgarisë, ku njëkohësisht ka qenë gjyqtare ndërkombëtare në Gjykatën e Bosnjes dhe Hercegovinës dhe anëtare e Panelit. Nga nëntori i vitit 1998 deri në prill të vitit 2008, ajo ka qenë gjyqtare në Gjykatën Evropiane për të Drejta të Njeriut.

15. Znj. Botusharova doktoroi në drejtësi në Universitetin Lomonosov të Moskës. Ajo ka punuar si avokate në Odën e Avokatëve të Sofjes para se të bëhej profesoreshë e të drejtës kushtetuese në Universitetin Kliment Ohridski të Sofjes, në Universitetin e Ri të Sofjes dhe në Univeristetin Neofit Rilski në Blagoevgrad.

16. Znj. Botusharova ka qenë deputete e Kuvendit të Bullgarisë nga radhët e Unionit të Forcave Demokratike dhe ishte njëra nga autorët e Kushtetutës së re të Bullgarisë. Ajo u rizgjodh në mandatin e 36-të të Kuvendit të shtetit, ishte zëvendëskryetarja e tij dhe ushtruesja e detyrës së kryetares prej shtatorit deri në nëntor të vitit 1992. Si anëtare e Kuvendit, ajo morri pjesë në veprimtari të ndryshme legjislative, duke përgatitur bazën ligjore për tranzicionin e Bullgarisë në demokraci dhe në sundim të ligjit. Ajo gjithashtu ishte anëtare e Komisionit Evropian të Këshillit të Evropës për demokraci përmes ligjit prej vitit 1991 deri 1994 dhe, në këtë kapacitet, ka hartuar mendime ligjore për propozimkushtetutën e Ukrainës, të Federatës Ruse dhe atë të Moldavisë. Prej vitit 1994 deri 1998 znj. Botusharova ka qenë ambasadore e jashtëzakonshme dhe fuqiplotë e Republikës së Bullgarisë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Znj. Botusharova është autore e librave dhe artikujve për të drejtën kushtetuese, në veçanti, për Kushtetutën e re të Bullgarisë dhe për çështje të të drejtave të njeriut.

17. Znj. Botusharova tani për tani punon si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.

2.2. Sekretaria e Panelit

18. Sekretaria e Panelit përbëhet prej një zyrtari ekzekutiv, dy zyrtarëve ligjorë dhe dy asistenteve administrative. Vendi i zyrtarit ekzekutiv ka qenë i lirë nga fundi i qershorit 2009, ku dy zyrtarët ligjorë që iu bashkuan Sekretarisë në maj dhe qershor 2009 kanë kryer detyrat e zyrtarit ekzekutiv gjatë pjesës së mbetur të vitit 2009. Më poshtë në tekst janë dhënë informatat biografike të anëtarëve të Sekretarisë që kanë punuar gjatë vitit 2009.

2.2.1. Anëtarët e Sekretarisë në fund të vitit 2009

19. **Nedim Osmanagiq**, shtetas i Bosnjës, iu bashkua Sekretarisë si zyrtar ligjor në fund të qershorit 2009, ku ishte zyrtar përgjegjës i Sekretarisë dhe ushtrues detyre i zyrtarit ekzekutiv të saj gjatë pjesës së mbetur të vitit. Z. Osmanagiq i sjell Sekretarisë përvojën e tij të zëvendësavokatit të popullit për Bosnjë dhe Hercegovinë, të zyrtarit për të drejta të njeriut në Zyrën e Komisionerit të lartë për të drejta të njeriut në Prishtinë, të inspektorit të lartë gjyqësor në UNMIK, të zyrtarit ligjor në Komisionin e Venedikut të Këshillit të Evropës, të UNMIK-ut dhe të UNMBIH, të këshilltarit për të drejta të njeriut në misionin e OSBE-së në Bosnje dhe Hercegovinë, si dhe përvojën e UNDP-së në Somali.

20. **Ravi K. Reddy**, shtetas amerikan dhe anëtar i Odës së Avokatëve të Nju Jorkut, iu bashkua Sekretarisë si zyrtar ligjor në maj të vitit 2009. Më parë z. Reddy ka shërbyer si zyrtar ligjor në zyrën e drejtorit të Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut dhe si zyrtar ligjor në Programin e Shteteve të Bashkuara për avokim të Human Rights Watch. Z. Reddy ka kryer magjistraturën në fushën e të drejtave të njeriut në Univeristetin e Notinghamit, ka doktoruar në Universitetin e Pitsburgut dhe ka diplomuar në arte dhe histori në Universitetin e Delaveres.

21. **Snezhana Martinoviq** është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretari që nga dhjetori 2007. Ajo ia filloi punën në Kombet e Bashkuara në vitin 2000, ku ka punuar si asistente administrative në Departamentin e drejtësisë të UNMIK-ut.

22. **Mimoza Arifi-Hoxha** është punonjëse vendore, e cila punon si asistente administrative në Sekretari që nga nëntori i vitit 2008. Ajo ia filloi punën në Kombet e Bashkuara në dhjetor të vitit 1999 në cilësinë e asistentes administrative në Divizionin e informimit publik/zyrën e medieve të UNMIK-ut.

2.2.2. Anëtarët e Sekretarisë që kanë shërbyer gjatë pjesës së parë të vitit 2009

23. Gjatë vitit 2009, ish-zyrtari i saj i kamotshëm ekzekutiv doli nga Sekretaria.

24. **John J. Ryan**, shtetas i Irlandës ishte zyrtar ekzekutiv i Sekretarisë nga shtatori 2007 deri në qershor 2009. Ai më parë ka punuar si avokat me organizatën Stephen

MacKenzie and Co. Solicitors, nga Dablina në Irlandë. Ai gjithashtu ka qenë i punësuar si udhëheqës i Divizionit për përkrahje ndërkombëtare gjyqësore në Departamentin e drejtësisë të UNMIK-ut, e më pastaj ka punuar si zyrtar i lartë ligjor në Zyrën e PSSP-së, UNMIK. Z. Ryan ka diplomuar në drejtësi në Universitetin e Limerikut në Irlandë. Gjithashtu ka kryer studimet evropiane dhe ka diplomuar në fakultetin e drejtësisë në Shoqërinë e inkuorporuar të drejtësisë të Irlandës.

25. Paneli i është mirënjohës z. Ryan, i cili themeloi Sekretarinë dhe udhëhoqi me aftësi Panelin gjatë viteve të para të punës së tij.

26. Falë zemërgjerësisë së qeverisë së Finlandës, por edhe për shkak të efektit të papritur të zvogëlimit të Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut, gjatë periudhave të ndryshme të pjesës së parë të vitit 2009, Sekretaria ka përfituar nga shërbimet e zyrtarit për të drejta të njeriut dhe të zyrtarëve ligjorë të cekur më poshtë.

27. **Elina Castren**, shtetase e Finlandës, ka shërbyer si zyrtare për të drejta të njeriut në Sekretari e dërguar nga Qeveria e Finlandës, duke filluar nga dhjetori 2008 deri në qershor 2009. Znj. Castren e la Panelin në qershor 2009 për t'iu bashkuar Misionit për sundim të ligjit të Bashkimit Evropian (EULEX) si zyrtare ligjore në Gjykatën e qarkut në Gjilan.

28. **Bernadette Foley**, shtetase e Amerikës, e cila ka shërbyer si zyrtare ligjore në Sekretari nga dhjetori 2008 deri në qershor 2009. Ajo më parë ka punuar si inspektore e lartë gjyqësore në Zyrën e këshillit disiplinor të UNMIK-ut. Nga viti 2005 deri 2006 ajo ka menaxhuar, hartuar dhe zbatuar programin e aftësisimit për hetuesit e shkëlqeve të bëra nga gjyqtarët dhe prokurorët në kuadër të projektit të përbashkët të UNDP-së/UNMIK-ut. Prej vitit 2002-2004 ajo ka qenë bashkëpunëtoresh vizituese e fakultetit, ku ka ligjëruar drejtësinë në universitetin rus, nën sponsorizimin e projektit për edukim civil të Institutit për Shoqëri të Hapur. Prej vitit 1981 deri në vitin 2001, ajo ka qenë avokate në SHBA në fushën e së drejtës penale dhe të shëndetit mendor.

29. **Jerina Dampier**, shtetase e Amerikës dhe anëtare e Odës së avokatëve të Nju Jorkut. Ajo ka punuar si zyrtare ligjore në Sekretari nga shkurti 2009 deri në maj 2009. Më parë, znj. Dampier ka shërbyer si zyrtare ligjore në Departamentin e administratës civile të UNMIK-ut, në Divizionin penal të Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut dhe në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Znj. Dampier tani për tani është këshilltare ligjore e kryetarit të Komisionit ndërkombëtar gjyqësor dhe prokurorisë në Kosovë.

30. **Butera Mpira**, shtetase e Ruandës, ka shërbyer si zyrtare ligjore në Sekretari duke filluar nga marsi 2009 deri në qershor 2009. Më parë, znj. Mpira ka shërbyer si zyrtare ligjore në Divizionin për përkrahje ndërkombëtare gjyqësore të Departamentit të drejtësisë të UNMIK-ut dhe ka punuar në organizatën joqeveritare Nonviolent Peaceforce (Forca paqësore e padhunshme) në Shri Lankë. Znj. Mpira aktualisht punon si avokate private në Kigali, Ruandë.

31. **Chiara Rojek**, shtetase e Francës, ka punuar si zyrtare ligjore në Sekretari nga marsi 2009 deri në qershor 2009. Më parë, znj. Rojek ka punuar si zyrtare ligjore në Divizionin për përkrahje ndërkombëtare gjyqësore të Departamentit të drejtësisë të

UNMIK-ut dhe si zyrtare ligjore në Dhomën e jashtëzakonshme të gjykatave të Kamboxhias për ndjekjen penale të krimeve të kryera gjatë periudhës së Kampuçisë Demokratike.

3. Korniza rregulluese

3.1. Rregullorja nr. 2006/12

32. Korniza kryesore ligjore për punën e Panelit mbetet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/13, përmes së cilës i jepen autorizimet Panelit për shqyrtimin e ankesave me diapazon të gjerë lidhur me shkeljen e drejtave të njeriut që pretendohet se janë bërë nga UNMIK-u duke u bazuar në instrumentet vijuese: Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Juridiksioni kohor i Panelit fillon nga 23 prilli 2005.⁷

33. Procedura e Panelit përbëhet prej dy fazave kryesore⁸: e para ka të bëjë me shqyrtimin e pranueshmërisë, ndërsa faza e dytë me rastin e shpalljes së ankesës si të pranueshme dhe me shqyrtimin e bazueshmërisë së saj. Pranueshmëria përcaktohet përmes një vendimi formal, ku ceket edhe arsyetimi i tij. Në disa raste, Paneli fillimisht ka marrë vendim të pjesshëm për pranueshmërinë, dhe më pastaj në vendimin e formës së prerë janë përcaktuar çështjet e mbetura të pranueshmërisë. Vendimet publikohen në faqen e internetit të Panelit pasi të jenë njoftuar palët në procedurë. Nëse Paneli shpall si të pranueshme tërë ankesën apo pjesë të caktuara të saj, pastaj fillon me shqyrtimin e bazueshmërisë së ankesës.

34. Nëse shqyrtimi i ankesës vazhdon me shqyrtimin e bazueshmërisë së saj, Paneli do të dal me një mendim nëse ankuesit i janë shkelur të drejtat e njeriut, në të cilin mund t'i paraqiten PSSP-së edhe rekomandimet⁹. Pasi t'u jetë dhënë mendimi palëve, të njëjtit gjithashtu publikohen në faqen e internetit të Panelit¹⁰. Nga ky moment, vetëm PSSP-ja ka autorizim për të vepruar apo jo në bazë të gjetjeve të Panelit.¹¹

3.2. Urdhëresa administrative nr. 2009/1

35. Më 17 tetor 2009, PSSP-ja ka shpallur Urdhëresën administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut. Përmes kësaj Urdhërese administrative ndryshohen kriteret për pranueshmëri, procedura për shqyrtimin e ankesave, mënyra e mbajtjes së seancave publike dhe procedura e emërimit për anëtarët e Panelit. Përmes kësaj Rregulloreje gjithashtu rregullohet mënyra e botimit të komunikatave për shtyp dhe e shpalljeve të Panelit. Po kështu, aty parashihet data e fundit për dorëzimin e ankesave pranë Panelit.

⁷ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, Neni 2. Shih gjithashtu paragrafin 45, *infra*.

⁸ Për përshkrime të mëtejshme të procedurës së Panelit, shih pjesën 4 të këtij raporti.

⁹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.1.

¹⁰ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.2.

¹¹ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 17.3.

36. Çështja e parë procedurale e përcaktuar përmes Urdhëresës administrative ka të bëjë me mundësinë që PSSP-ja të jep komente për pranueshmërinë e ankesës. Në fakt, përveç nëse ankesa nuk shpallet menjëherë si e papranueshme, Paneli zakonisht¹² ia komunikon ankesën PSSP-së në mënyrë që ai t'i jep komentet e tij rreth pranueshmërisë dhe bazueshmërisë. Në nenin 2.3 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 tani parashihet që “komentet për bazueshmëri të shkeljes së pretenduar të së drejtës së njeriut të dorëzohen vetëm pasi që Paneli Këshillëdhënës të ketë kryer shqyrtimin e tij të ankesës dhe të ketë përcaktuar pranueshmërinë e saj”.

37. Në disa raste kur Paneli ka konstatuar se pranueshmëria e ankesës ka qenë ngushtë e lidhur me bazueshmërinë e saj, gjegjësisht në rastet kur ankesa kishte të bënte me paefektshmërinë e mjetit ligjor apo të hetimit, ose me mospasjen e qasjes në gjykatë, vendimit të tij për pranueshmërinë ia ka bashkëngjitur çështjen e pranueshmërisë për shqyrtimin e bazueshmërisë. Neni 2.1 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 duket se reagon ndaj kësaj praktike, përmes së cilës parashihet që Paneli të “shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë para se të shqyrtohet bazueshmëria”.

38. Neni 2.1 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 gjithashtu parashihet që çështjet e pranueshmërisë të shqyrtohen “në çdo fazë të procedurës”, që nënkupton se mund të ngritjen çështje të reja të pranueshmërisë në çdo moment, edhe pasi që ankesa të jetë shpallur e pranueshme. Përmes nenit 2.3 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut konfirmohet ky interpretim, ku thuhet: “Nëse çështjet e pranueshmërisë së ankesës trajtohen në çfarëdo kohe pasi që Paneli Këshillëdhënës të ketë marrë vendimin për pranueshmërinë e ankesës dhe të ketë filluar shqyrtimin për bazueshmërinë e saj, Paneli Këshillëdhënës pezullon shqyrtimin për bazueshmëri deri në rivlerësimin e plotë të pranueshmërisë së ankesës dhe në përcaktimin e serishëm të saj”. Paneli ka shqetësime se dispozita e fundit mund të çojë në situata kur vërejtja e re ndaj pranueshmërisë së ankesës që më parë është shpallur si e pranueshme të rezultojë me vonesë të konsiderueshme në procedurë.

39. Sa i përket kriterëve të pranueshmërisë, neni 2.2 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 është i rëndësishëm thelbësor. Aty thuhet: “Cilado ankesë që është pjesë e procesit apo procedurave të OKB-së për kërkesat e palëve të treta sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të punonjësve të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000¹³, konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi dhe procedurat e OKB-së për kërkesat e palëve të treta sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete të disponueshme ligjore në pajtim me nenin 3.1 të (Rregullores nr. 2006/12).” Kjo dispozitë ka efektin e heqjes së kompetencës së Panelit për të vlerësuar

¹² Por shih Rregulloren e punës së PKDNJ-së, Rregulla 29bis, e përfshirë më 11 shtator 2009 (e diskutuar *infra*).

¹³ Neni 7 i Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe të punonjësve të tyre në Kosovë parashihet si në vijim: “Kërkesat e palëve të treta për humbjen apo dëmtimin e pronës, si dhe për lëndime personale, sëmundje ose vdekje që rrjedhin apo i atribuohen drejtpërsëdrejti KFOR-it, UNMIK-ut ose punonjësve të tyre dhe të cilat nuk vijnë si rrjedhojë e ‘nevojës operationale’ të asnjërës prej pranive ndërkombëtare, rregullohen nga Komisioni për kërkesa, i themeluar nga KFOR-i dhe UNMIK-u, sipas mënyrës e cila do të përcaktohet.”

efektshmërinë e procesit të OKB-së për kërkesat e palëve të treta ¹⁴, nga aspekti i kushtit që “të gjitha ... mjetet ligjore në dispozicion për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara të jenë kërkuar” (neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12). Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1 vlen jo vetëm për ankesat e parashtruara pas lëshimit të saj, por gjithashtu edhe për të gjitha ankesat e pazgjidhura (neni 6).

40. Efekti konkret i dispozitës së re do të duhet të përcaktohet prej rastit në rast. Megjithatë, mund të pritet që një numër ankesash, duke përfshirë disa në lidhje me rastet më serioze, do të duhet të shpallen si të papranueshme. Siç është cekur më lart, çështja e pranueshmërisë mund të ngritet në bazë të nenit 2.2 të Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2009/1 edhe në rastet kur Paneli ka shpallur ankesën si të pranueshme dhe kur është në fazë të shqyrtimit të bazueshmërisë së saj.

41. Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1 gjithashtu rregullon organizimin e seancave publike. Neni 1.1 parasheh që “seancat publike (...) mbahen në atë mënyrë dhe vend që krijon një ndjenjë të qartë të procedurave jokundërshtuese që do t’ju bartet të gjithë pjesëmarrësve dhe publikut në përgjithësi, duke përfshirë edhe cilado medieve të pranishme, në rast se ajo prani lejohet nga Paneli Këshillëdhënës”. Karakteri jokundërshtues i procedurave përsëri përmendet në nenin 1.4, në bazë të të cilit “vendi dhe rregullimet e ulëseve për seancat publike të organizuara nga Paneli do të jenë në përputhje me natyrën jokundërshtuese të procedurës”. Përderisa mund të jetë befasuese që PSSP-ja t’i jep udhëzime Panelit lidhur me vendin e mbajtjes së seancave dhe, madje, edhe me mënyrën e uljes në seanca, është e qartë se qëllimi kryesor i dispozitave të lartpërmendura është theksimi i karakterit jokundërshtues jo vetëm të seancës, por edhe të procedurave para Panelit në tërësi. Sa i përket kësaj çështjeje, Paneli mendon se është vështirë të përputhet Urdhëresa administrative me frymën, në mos edhe me formulimet e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. ¹⁵ Për më tepër, përmes Urdhëresës administrative në mënyrë të dukshme zvogëlohet dobia e çfarëdo seance. Neni 1.2 në fakt parasheh që “gjatë seancave publike, ankuesit apo përfaqësuesi i tyre, lejohen të japin deklaratë që do të përmblihte shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut, ashtu siç janë paraqitur në parashtrësat me shkrim për Panelin Këshillëdhënës”, ndërsa “Paneli Këshillëdhënës do t’u parashtrtojë pyetje palëve apo përfaqësuesve të tyre, që qartësojnë bazën faktike të ankesës dhe që janë të nevojshme për Panelin Këshillëdhënës për të vlerësuar në mënyrë të plotë pretendimin për shkelje të të drejtave të njeriut që gjendet para tij”. Kjo dispozitë jo vetëm që vërteton se seanca nuk është kundërshtuese pasi që palët nuk mund të komentojnë për parashtrësat e njëri-tjetrit, por gjithashtu kufizon qëllimin e seancës dëgjimore thjesht në një qartësim të fakteve (tani më të cekura në

¹⁴ Procesi i OKB-së për kërkesat e palëve të treta është pjesë e Rezolutës 52/247 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, të datës 17 korrik 1998 për “Përgjegjësinë e palëve të treta: kufizimet kohore dhe financiare” (A/RES/52/247). Neni i lartpërmendur 7 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 paraqet zbatimin e rezolutës së lartpërmendur në kontekstin e UNMIK-ut.

¹⁵ Neni 11.3 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që PSSP-ja ka mundësinë të parashtrtojë përgjigjen ndaj ankesës në emër të UNMIK-ut pasi që ajo të jetë shpallur si e pranueshme. Neni 11.4 ia mundëson Panelit që të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtrësata të tjera me shkrim. Këto dispozita tregojnë se ka qenë qëllim i hartuesve që të përfshijnë ankuesin dhe UNMIK-un në procedurë, ku ata do të ishin në gjendje t’i paraqesin pikëpamjet e tyre dhe të komentojnë në pikëpamjet e njëri-tjetrit. Pastaj, është detyrë e Panelit, në bazë të nenit 17.1, t’i bëjë konkludimet nëse ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut, të cilat domosdo përfshijnë marrjen parasysh të parashtrësave të bëra nga ankuesi dhe UNMIK-u.

parashtrerasat me shkrim), duke përjashtuar kështu çfarëdo diskutimi për çështje ligjore. Në frymën e dispozitave të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, të cilat dukshëm kufizojnë qëllimin që do të mund të ndiqej përmes seancave dëgjimore, gjasat janë të vogla që një seancë e tillë dëgjimore të mund të mbahej në të ardhmen¹⁶.

42. Një çështje tjetër që rregullohet përmes Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 është procedura për emërimin e anëtarëve të tij. Në bazë të nenit 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 “Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit Këshillëdhënës pas propozimit të kryetarit të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut”. Kjo dispozitë mund të shihet si garanci e pavarësisë (kundruall UNMIK-ut dhe PSSP-së) së Panelit dhe e anëtarëve të tij. Neni 3.1 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 tani parasheh që kryetari i Gjykatës Evropiane “propozon, në përputhje me rregullat e prokurimit në fuqi të OKB-së, numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim (...). Nëse nuk pranohen propozime të mjaftueshme nga UNMIK-u brenda periudhës prej 1 muaji kalendarik të kërkesës së tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e duhur pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare për të drejta të njeriut”.

43. Neni 3.2 i Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1 parasheh që “në rast se një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga pozita, Paneli nuk do të merr vendime deri në emërimet e reja (...)”. Kjo dispozitë kishte efektin e ndalimit të Panelit nga marrja e çfarëdo vendimi për pranueshmërinë apo të miratimit çfarëdo mendimi për bazueshmërinë nga data e lëshimit të Urdhëresës administrative deri në datën e deklaratës solemne që duhet të bëhet nga anëtari i ri i tretë i Panelit.¹⁷

44. Nuk ka shumë të thuhet për nenin 4 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, përmes të cilit Paneli urdhërohet t’i bëjë publikimet, shpalljet dhe komunikatat për shtyp përmes Zyrës së zëdhënësit dhe informimit publik të UNMIK-ut. Paneli vlerëson konfirmimin e disponueshmërisë së Zyrës së lartpërmendur për t’i ndihmuar Panelit në shpalljet e tij. Në të kaluarën, Paneli ka mundur ta dërgojë raportin e tij vjetor dhe komunikatat (relativisht të rralla) të tij për shtyp drejtpërdrejt tek personat dhe organizatat në listën e tyre të adresave elektronike, para se të vendoseshin në faqen e internetit të Panelit nga Zyra e lartpërmendur.

45. Në fund, neni 5 i Urdhëresës administrative nr. 2009/1 parasheh datën e fundit për parashtrimin e ankesave Panelit që është data 31 mars 2010. Ankesat e pranura pas kësaj date do të duhet të refuzohen. Kjo dispozitë duhet të interpretohet në kontekst të rikonfigurimit të UNMIK-ut për shkak të vështirësive me të cilat ballafaqohet në ushtrimin e mandatit të tij sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit 1244 (1999).¹⁸

3.3. Rregullorja e punës

¹⁶ Shih paragrafin 71, *infra*.

¹⁷ Siç është theksuar më lart, znj. Botusharova ka dhënë dorëheqje në qershor 2009. Pasardhësja e saj znj. Christine Chinkin, bëri deklaratën solemne në shkurt 2010.

¹⁸ Shih raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, të datës 24 nëntor 2008, S/2008/692, nr. 21. Shih më tej, *infra*, paragraf 61.

46. Më 11 shtator 2009 Paneli ndryshoi Rregulloren e tij të punës duke futur Rregullën 29 *bis*. Rregulla e re ia mundëson Panelit që menjëherë të shpallë ankesën si të pranueshme, pra, pa ia komunikuar ankesën PSSP-së. Kjo rregull u bë e nevojshme për shkak të numrit në rritje të ankesave të përsëritura.

47. Më 21 nëntor 2009 Paneli prapë ndryshoi Rregulloren e vet të punës, duke futur Rregullën 39*bis*. Rregulla e re parashih kufizimet për zbulimin e provave apo dëshmi. Zbulimi i tyre mbetet si rregull e përgjithshme, por Paneli mund të autorizoj që dëshmi të caktuara të mos i zbulohen palës tjetër në procedurë, “në mënyrë që të ruhet interesi i rëndësishëm publik apo të ruhen të drejtat themelore të ankuesit ose të cilitdo person tjetër në fjalë”. Rregulla e re është miratuar si reagim ndaj vështirësive të hasura në raste të caktuara lidhur me personat e pagjetur, ku çështja ka qenë ende nën hetimet e policisë.

4. Administrimi i ankesave

48. Paneli e konsideron të udhës ta përshkruajë mënyrën e administrimit të ankesave, duke u bazuar në praktikën e tij gjatë periudhës nën shqyrtim¹⁹.

49. Ankesat parashtrihen nga personat që besojnë se UNMIK-u ose ndonjë autoritet nën UNMIK-un në një mënyrë apo tjetrën ka shkelur të drejtat e tyre të njeriut. Ankuesit zakonisht përdorin formularët për ankesa që mund të gjenden në faqen e internetit të Panelit për parashtrimin e ankesave të tyre. Shpesh parashtruesit e ankuesve përmbajnë informata të pamjaftueshme dhe ata mund të bashkëngjisin nga disa dokumente. Nganjëherë, ankuesit përfaqësohen nga avokati dhe parashtrojnë ankesa të hollësishme në formate që zakonisht janë të ngjashme me parashtrimin e dokumenteve ligjore para gjykatave dhe tribunaleve në regjion.

50. Pas pranimit të ankesës së parë, Sekretaria cakton numrin e lëndës dhe e dërgon ankesën për përkthim në gjuhën angleze. Pas pranimit të rastit të përkthyer, kryesuesi e shqyrton atë dhe cakton raportuesin nga anëtarët e Panelit, i cili më pastaj është përgjegjës për bartjen e atij rasti nëpër procedurat e Panelit.²⁰ Kryesuesi apo zyrtari ekzekutiv cakton zyrtarin ligjor për lëndën në fjalë.

51. Raportuesi dhe zyrtari ligjor bëjnë shqyrtimet fillestare për të përcaktuar nëse ka informata të mjaftueshme në ankesë në mënyrë që Paneli të vendosë nëse rasti është i pranueshëm apo jo. Zyrtari ligjor është shpesh personi i parë që shqyrton rastin. Nëse, pas shqyrtimit të rastit, zyrtari ligjor vëren se ankesa lehtë mund të vendoset në kuadër të kornizës ekzistuese të praktikës së Panelit, ai ndërmerr veprimin e nevojshëm (duke kërkuar informata të caktuara nga ankuesi, UNMIK-u apo nga palët e treta). Nëse ankesa ngrit çështje të reja apo të ndërlikuara, atëherë ankesa lihet anash dhe shqyrtimi fillestar bëhet gjatë seancës së ardhshme të Panelit.

52. Pavarësisht nëse zyrtari ligjor është në gjendje të ndërmerr ndonjë veprim fillestar lidhur me rastin, raportuesi paraqet ankesën për diskutim në sesionin e ardhshëm të Panelit. Paneli më pastaj do të udhëzojë Sekretarinë që të ndërmerr çfarëdo veprimi të nevojshëm, dhe mund të vendosë për pyetjet paraprake, siç është

¹⁹ Grafiku i rrjedhës së lëndëve të PKDNJ-së është bashkëngjitur si shtojca D.

²⁰ Rregullorja e punës së PKDNJ-së, Rregulla 28.

ajo nëse rasti mund t'i bashkëngjitet rasteve të tjera pranë Panelit,²¹ apo t'i komunikohet PSSP-së për dhënien e komenteve mbi pranueshmërinë.

53. Nëse nga palët kërkohen informata të tjera,²² atëherë pas pranimit dhe përkthimit të përgjigjes, e njëjta vlerësohet nga Paneli. Nëse ende nuk ka informata të mjaftueshme për të përcaktuar nëse ankesa është e pranueshme apo jo, atëherë nga ankuesi, UNMIK-u apo pala e tretë do të kërkohen informata shtesë²³. Nëse ka informata të mjaftueshme për të përcaktuar çështjet e pranueshmërisë, Paneli do të shqyrton ankesën dhe do të vendosë nëse duhet të shpallet si e pranueshme apo e papranueshme. Në raste të jashtëzakonshme ankesa mund të hiqet nga lista²⁴.

54. Nëse ankesa nuk është qartazi e papranueshme dhe nuk ngrit çështje që thelbësisht janë të njëjta me ato që janë ngritur në ankesa të tjera që tani më janë shpallur të pranueshme²⁵, Paneli do t'ia komunikon ankesën PSSP-së në mënyrë që ai të jap komente për pranueshmërinë e ankesës.²⁶ Komentet e PSSP-së për pranueshmërinë e ankesës shqyrtohen dhe, përderisa nuk përfshihet ndonjë informatë që ka qenë subjekt i kërkesës për kufizime në zbulimin e provës të cilën rrjedhimisht Paneli e jep²⁷, komentet do t'i dërgohen ankuesit qoftë për marrjen e komenteve shtesë nga ai apo vetëm për informimin e tij varësisht nga natyra e komenteve. Pas përfundimit të këtij procesi dhe pasi që Paneli të jetë i kënaqur që të dyja palët kanë mundur të japin komentet e tyre për çështjen, Paneli prapë do të shqyrtojë çështjen dhe do të merr vendim mbi pranueshmërinë e ankesës.²⁸ Raportuesi apo zyrtari ligjor më pastaj do të përgatisin vendimin mbi pranueshmërinë²⁹.

55. Pasi që Paneli të ketë miratuar vendimin, i njëjti nënshkruhet nga kryesuesi dhe zyrtari ekzekutiv³⁰ dhe përkthehet në shqip dhe serbisht. Pasi që përkthimi të jetë përfunduar në gjuhën e ankuesit, vendimi i dërgohet ankuesit dhe UNMIK-it. Pasi që palët të kenë marr vendimin, dhe pasi që përkthimet të përfundohen, i njëjti publikohet në internet në gjuhën angleze, shqipe dhe atë serbe.

56. Nëse rasti shpallet si plotësisht i papranueshëm apo hiqet nga lista, atëherë lënda mbyllet.³¹

57. Megjithatë, nëse i tërë rasti, apo një pjesë e tij, shpallet si e pranueshme, atëherë Paneli duhet të fillojë shqyrtimin e bazueshmërisë së rastit.³² Pas marrjes së vendimit

²¹ Shih Rregulloren e punës së PKDNJ-së, Rregulla 20.

²² Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 11.2

²³ Përderisa nganjëherë ankesa mund të përmbajë të gjitha informatat në posedim të ankuesit dhe mund të jetë e mjaftueshme për rastin prima facie, shpesh ndodhë që të kërkohen informata shtesë nga UNMIK-u apo palët e tretë në mënyrë që të kemi pasqyrë të plotë të ngjarjeve që i kanë paraprirë ankesës.

²⁴ Rregullorja e punës së PKDNJ-së, Rregulla 29.

²⁵ Rregullorja e punës së PKDNJ-së, Rregulla 29bis, shtuar më 11 shtator 2009.

²⁶ Lidhur me praktikën e Panelit që të ftojë PSSP-në për dhënien e komenteve edhe për bazueshmërinë e ankesës, shih më lart paragrafin 36.

²⁷ Rregullorja e punës së PKDNJ-së, Rregulla 39bis, shtuar më 12 nëntor 2009.

²⁸ Shih në përgjithësi Rregulloren e punës së PKDNJ-së, Rregulla 30.

²⁹ Anëtari i cili nuk pajtohet apo pajtohet mund të bashkëngjitet mendimin e vet mendimit të shumicës. Deri më tani kjo nuk ka ndodhur.

³⁰ Rregullorja e punës së PKDNJ-së, Rregulla 42.

³¹ Ndonëse Paneli mund të pranojë kërkesë për rishqyrtim dhe, varësisht nga natyra e kërkesës, mund të trajtojë atë përmes vendimit të ri mbi pranueshmërinë.

që shpallë ankesën e pranueshme, UNMIK-u duhet të përgjigjet me komentet e veta mbi bazueshmërinë e ankesës brenda njëzet ditëve nga marrja e vendimit.³³ Megjithatë, në praktikë Paneli shpeshherë zgjat afatin kohor prej njëzet ditëve pas kërkesës nga PSSP-ja .

58. Gjatë shkëmbimit të pikëpamjeve dhe procesit të mbledhjes së informatave, Paneli shqyrton bazueshmërinë e ankesës sipas nevojës. Pasi që palët t'i kenë shkëmbyer pikëpamjet e tyre dhe Paneli të ketë mbledhur të gjitha informatat e kërkuara, Paneli prapë do të shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës dhe do të përcaktojë nëse faktet tregojnë për shkelje të të drejtave të njeriut të ankuesit. Raportuesi apo zyrtari ligjor më pastaj do të duhet të përgatisë një mendim mbi bazueshmërinë e ankesës.³⁴ Nëse Paneli zbulon se UNMIK-u është përgjegjës për shkeljen e të drejtave të njeriut të ankuesit, ai mund t'i jap UNMIK-ut rekomandime, përfshirë, aty ku është e duhur, rekomandime mbi kompensimin që duhet ofruar.

59. Pasi që Paneli të miraton vendimin, i njëjti nënshkruhet nga kryesuesi dhe nga zyrtari ekzekutiv³⁵, ndërsa Sekretaria zbaton të njëjtën procedurë të shpërndarjes dhe të vendimeve të përshkruara siç ishte rasti në paragrafin 55 më lart.

60. Pasi që Paneli të miraton mendimin e tij, PSSP-ja mban pushtetin ekskluziv për të vendosur se a të veprohet në bazë të konkludimeve dhe rekomandimeve të Panelit në pajtim me nenin 17 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Vendimet e PSSP-së në këtë drejtim duhet që menjëherë të publikohen në gjuhën angleze, shqipe dhe atë serbe në mënyrën që siguron një shpërndarje dhe qasshmëri të gjerë.³⁶

5. Nismat për informim publik

61. Pas tërheqjes së përgjithshme të UNMIK-ut nga ushtrimi i funksioneve të përgjithshme në Kosovë në vitin 2008³⁷, Paneli vendosi të mos angazhohet në ndonjë fushatë të gjerë të informimit të qytetarëve. Pasi që UNMIK-u është duke i zvogëluar përgjegjësitë e tij, ka gjasa që më pak ankesa të shpallen si të pranueshme dhe Paneli ka kërkuar t'i ikë rritjes së pritjeve nga ana e ankuesve, duke inkurajuar aplikuesit të parashtrajnë ankesa të reja.

62. Megjithatë, Paneli do të fillojë së paku një fushatë të informimit publik në fillim të vitit 2010, në frymën e nenit 5 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, e cila parasheh që Paneli më nuk do të mund të pranohet ankesa që do të parashtrohen pas datës 31 mars 2010. Pasi që kjo informatë nuk dihet në mbarë regjionin, atëherë do të botohen shpallje në gazetatat regjionale (në *Danas* dhe *Politika* që botohen në Beograd në gjuhën serbe dhe në *Koha Ditore* që botohet në Prishtinë në gjuhën shqipe) për t'u siguruar që qytetarët në përgjithësi të jenë në dijeni për afatin e fundit.

³² Rregullorja e punës e PKDNJ-së, Rregulla 34.

³³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12, neni 11.3.

³⁴ Shih në përgjithësi, Rregullorja e punës e PKDNJ-së, Rregulla 36. Nëse anëtari i Panelit pjesërisht nuk pajtohet apo pajtohet, ai mund të përgatisë mendimin mospajtures apo pajtures.

³⁵ Rregullorja e punës e PKDNJ-së, Rregulla 42.

³⁶ Deri më tani, PSSP-ja nuk ka botuar ndonjë vendim vetëm në bazë të rekomandime të bëra deri më tani nga Paneli i PKDNJ-së, lënda *Canhasi*, Lënda nr. 04/08, mendimi i datës 12 nëntor 2008.

³⁷ Pas deklaratës presidenciale të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të datës 26 nëntor 2008, S/PRST/2008/44, ku mirëpritet angazhimi i vazhdueshëm i Bashkimit Evropian në Kosovë.

6. Numri i lëndëve në Panel dhe të dhënat statistikore

6.1. Të dhënat statistikore

63. Paneli ka pranuar gjithsej 351 ankesa gjatë kësaj periudhe raportuese, duke ngritur kështu numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar nga Paneli në 435, nga të cilat 406 presin zgjidhje dhe janë në faza të ndryshme të procedurës. Në fund të vitit 2009, 176 raste ishin në pritje të përkthimit.

64. Gjatë periudhës raportuese, Paneli ka marrë një vendim të pjesshëm për bazueshmëri, 22 vendime për pranueshmëri dhe/apo për heqjen e lëndëve nga lista. Paneli shpalli dy lëndë si plotësisht të pranueshme, nëntë lëndë pjesërisht të pranueshme dhe tetë lëndë si plotësisht të papranueshme. Gjithashtu, Paneli hoqi tri lëndë nga lista.

65. Në fund të vitit 2009, kanë qenë 406 lëndë që prisnin zgjidhje nga Paneli, ku 21 prej këtyre lëndëve prisnin mendimin për bazueshmërinë e tyre³⁸ dhe 385 lëndët e mbetura në pritje të vendimit fillestar për pranueshmëri.

Numri i lëndëve, komunikatave dhe vendimeve të PKDNJ-së prej vitit 2006 deri më 2009					
Numri i lëndëve	2006	2007	2008	2009	Gjithsej
Të pranuar	3	12	69	351	435
Të mbyllura	0	0	18	11	29
Në pritje të zgjidhjes	3	15	66	406	406

Komunikata	2006	2007	2008	2009	Gjithsej
Të komunikuar PSSP-së	N/V ³⁹	-	30	71	101
Përgjigje nga PSSP-ja	-	-	18	75	93
Në pritje të përgjigjes nga PSSP-ja	-	-	12	8	8

Vendimet: Lloji	2006	2007	2008	2009	Gjithsej
Gjithsej	-	-	32	23	55
Vendimet për pranueshmëri	-	-	28	22	50

³⁸ Në lëndët për të cilat ekziston mendimi i pjesshëm për bazueshmëri, lënda pret vendimin përfundimtar për bazueshmëri. Gjithashtu, pas shpalljes së Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, disa lëndë aktualisht presin mendimin për bazueshmëri, kërkojnë vendimin e dytë për pranueshmëri.

³⁹ Anëtarët e Panelit nuk janë emëruar deri në janar të vitit 2007 dhe Paneli nuk ka mbajtur seancën e tij të parë deri në nëntor 2007, andaj është përdorur shkurtesa “Nuk Vlen” (N/V).

Vendimet për pranueshmëri të pjesshme	-	-	2	0	2
Mendimet për bazueshmëri	-	-	1	0	1
Mendimet e pjesshme	-	-	0	1 ⁴⁰	1
Kërkesa për rishqyrtim	-	-	1	0	1
Vendime: gjetje	2006	2007	2008	2009	Gjithsej
Vendime: Plotësisht të pranueshme	-	-	11	2	13
Vendime: Të pranueshme pjesërisht, të papranueshme pjesërisht	-	-	2 ⁴¹	9	11
Vendime: Plotësisht të papranueshme	-	-	17	8	25
Vendime: Të hequra nga lista	-	-	0	3	3
Mendime: Shkelje	-	-	1	0	1
Mendime: nuk ka shkelje	-	-	0	1 ⁴²	1
Kërkesa për rishqyrtim: Të refuzuara	-	-	1	0	1

6.2. Tendencat në numrin e përgjithshëm të lëndëve dhe çështjet e tjera të rëndësishme

66. Disa tendenca në numrin e përgjithshëm të lëndëve të Panelit kanë mbetur të njëjta, ndërsa të tjerat kanë ndryshuar dukshëm nga periudha e fundit raportuese. Shumica e ankuesve që në mënyrë specifike thirren në instrument për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, së pari ankohen në bazë të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut. Megjithatë, një përqindje e madhe e ankesave të pranura gjatë periudhës raportuese nuk saktësuan se në cilin nen apo madje edhe cilin instrument ata mbështeten, ku ankuesit argumentonin se dëshirojnë “t’i kenë të gjitha, në të cilat kanë të drejtë sipas konventave ndërkombëtare”. Mungesa e saktësimi rrallë paraqet problem të madh nga pikëpamja e identifikimit të kornizës në bazë të së cilës duhet të analizohet ankesa. Megjithatë, mosaktësimi rrallë përfundon me argumente të mjegullta sipas ligjit, ku Sekretaria pothuajse gjithmonë duhet të kërkon informatat të tjera faktike nga ankuesit.

67. Për ndryshim nga periudha e fundit raportuese, pjesa më e madhe e lëndëve të pranura më 2009 u përqendruan në pretendimet për hetim të paefektshëm lidhur me

⁴⁰ Kjo i referohet mendimit të pjesshëm për bazueshmëri, ku Paneli vendosi një çështje domethënëse substanciale, por shtyri shqyrtimin e mëtejme të bazueshmërisë për një datë të mëvonshme; shih *infra*, paragrafin 94.

⁴¹ Lëndët në fakt janë dy vendime të pjesshme për pranueshmëri, PKDNJ, *Olga Lajoviq*, Lënda nr. 09/08 dhe *Gani Emini*, Lënda nr. 17/08

⁴² I referohet mendimit të pjesshëm për bazueshmëri të cekur në fusnotën 42 më lart.

zhdukjet dhe vrasjet që ndodhën në periudhën para, gjatë dhe pas ndezjes së luftës në Kosovë (1999), ku pretendohet për shkelje të së drejtës në jetë. Paneli po ashtu vazhdoi të pranojë raste që pretendonin tejzgjatjen e procedurave dhe mohimin e qasjes në gjykata në rastet e dëmtimeve, të parashtruara kundër KFOR-it, UNMIK-ut, Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisje (IPVQ) të Kosovës dhe komunave të ndryshme, ku pretendohet për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, si dhe për raste të tjera pronësore.

68. Përveç kësaj, një lëndë e parashtruar në vitin 2009 pretendon shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë për shkak të shpalljes së Urdhëresës administrative të UNMIK-ut 2009/1 dhe të efekteve të saj në disa procedura pranë Panelit. Paneli do të merr vendim për pranueshmëri të asaj lënde në fillim të vitit 2010 për shkak të ndikimit të saj të mundshëm për rastet e tjera që presin zgjidhje.

69. Në lëndën e *Ramadan Xhemës*, nr . 01/09, Paneli duhet të përcaktonte nëse dorëzimi i vendimit të Drejtorisë për kërkesa pronësore banesore për ankuesin ka qenë i efektshëm në mënyrë që të përcaktohet se kur ka filluar periudha gjashtëmujore. Lënda ka rëndësi të madhe në kontekst të Kosovës, për shkak të praktikave të kontestuara të listimeve apo ish-adresave, madje edhe në korrespondencë zyrtare. Paneli konsideron se ka pasur dërgesa të rregullta në adresa të dhëna nga ankuesit pavarësisht nëse ai ka qenë i pranishëm apo jo në momentin e dërgesës. Është përgjegjësi e palëve në cilëndo procedurë për t'u siguruar që t'i japin informata të sakta për kontakt gjyqit apo autoritetit në fjalë dhe që të përditësojnë atë informatë.

70. Gjithashtu, Paneli vazhdoi në vitin 2009 me punën në dy lëndët e profilit më të lartë, *Kadri Balaj dhe të tjerët*, Lënda nr. 04/07, lidhur me vrasjen e dy protestuesve dhe plagosjen e rëndë të të tjerëve gjatë protestës në Prishtinë, në shkurt të vitit 2007⁴³, dhe *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08, lidhur me helmimin e pretenduar me plumb në kampet e banuara nga romët, ashkalinjtë dhe egjiptasit e zhvendosur në regjionin e Mitrovicës në Kosovë⁴⁴.

71. Lidhur me lëndën *Kadri Balaj dhe të tjerët*, Paneli ka pasur për qëllim të mbajë seancë publike në fillim të vitit 2009, pas vendimit të tij të vitit 2008, përmes të cilit lënda deklarohet si e pranueshme. Megjithatë, seanca fillimisht ishte shtyrë për shkak të shqetësimeve të sigurisë të ngritura nga UNMIK-u. Pas kësaj, është mbajtur një seancë e mbyllur më 19 mars 2009, ku avokatët e ankuesve theksuan se refuzojnë të marrin pjesë në seancë të mbyllur, që rezultoi me shtyrjen për afat të pacaktuar të seancës për këtë lëndë. Pas miratimit të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr 2009/1, UNMIK-u ka kërkuar që Paneli të shqyrtojë pranueshmërinë e lëndës edhe njëherë. Paneli ka gjasa të nxjerrë vendim të ri për pranueshmërinë e lëndës pas emërimit të anëtarit të tretë të Panelit.

72. Paneli shpalli lëndën e *N.M. dhe të tjerëve*, të parashtruar në emër të 143 ankuesve romë, ashkalinjë dhe egjiptas si të pranueshme pjesërisht më 5 qershor 2009. Aspektet e ankesës të shpallura të papranueshme kryesisht kanë të bëjnë me disa individë që nuk plotësojnë kriteret e pranueshmërisë sepse ata nuk kanë qenë “viktima” dhe ankesat lidhur me kushtet në kampe për ata persona që më nuk ishin

⁴³ Shih PKDNJ, *Balaj dhe të tjerët*, Lënda nr. 04/07, vendim i 6 qershorit 2008.

⁴⁴ Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08, vendim i 5 qershorit 2009.

banorë të kampeve më shumë se gjashtë muaj para parashtrimit të ankesës.⁴⁵ Paneli konsideron aspekte të tjera të ankesës si të pranueshme, të cilat ngrisin çështje në bazë të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave dhe të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

73. Pas miratimit të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, UNMIK-u ka kërkuar që Paneli prapë të shqyrton pranueshmërinë e lëndës. Paneli ka gjasa të nxjerrë vendim të ri për pranueshmërinë e lëndës pas emërimit të anëtarit të tretë të Panelit.

74. Përveç kategorive të lëndëve të cekura më lart, Paneli vazhdoi të punojë në lëndë lidhur me:

- Pretendimet për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ), të drejtës për respektimin të jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 KEDNJ), të drejtës për mbrojtjen e pronës (neni 1 i Protokollit nr.1), si dhe të drejtës për mjet të efektshëm ligjor (neni 13 i KEDNJ-së) lidhur me vendimet e bëra nga Drejtoria për kërkesa banesore pronësore dhe Agjencia Kosovare e Pronave, si dhe Komisioni i saj për kërkesa pronësore përkitazi me pronësinë dhe banimin.
- Pretendimet për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ), të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 KEDNJ), të drejtës për mbrojtjen e pronës (neni 1 i Protokollit nr.1), si dhe të drejtës për mjet të efektshëm ligjor (neni 13 i KEDNJ-së) lidhur me dëbimet e pasuksesshme të uzurpuesve të paligjshëm të pretenduar të pronës.
- Pretendimet për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ), të drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare (neni 8 § 1 KEDNJ), të drejtës për mbrojtjen e pronës (neni 1 i Protokollit nr.1), si dhe të drejtës për mjet të efektshëm ligjor (neni 13 i KEDNJ-së) lidhur me vendimet e pretenduara kundërthënëse për lëndët pronësore mes Drejtorisë banesore pronësore apo Agjencisë Kosovare të Pronave dhe gjykatave komunale dhe atyre të qarkut.
- Pretendimet për shkeljen e të drejtës në gjykim të drejtë (neni 6 § 1 KEDNJ) dhe të drejtës për mbrojtjen e pronës (neni 1 i Protokollit nr. 1) përkitazi me vendimet e bëra nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit që kanë të bëjnë me përfitimet e të punësuarve që janë të pagueshme përmes privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH), si dhe në bazë të pronësisë së NSH-së.
- Pretendimet për shkeljen e të drejtës për mbrojtjen e pronës (neni 1 i Protokollit nr.1) lidhur me konfiskimin e pronës nga autoritetet e zbatimit të ligjit.

6.3. Mendimet dhe vendimet e Panelit sipas lëndëve

75. Më poshtë është paraqitur numri i lëndëve, të renditura sipas lëndëve:

⁴⁵ Për më shumë informata, shih *infra*, paragrafët 80-82.

Lëndët e vrasjes apo zhdukjes së personit të ndërlidhura me luftënE drejta në jetë – Ndalimi i torturës dhe trajtimit jonjerëzor apo poshtërues

- *Snezhana Zdravković* 46/08 (vendimi i datës 17 prill 2009) - i pranueshëm

Ankesa e personave të zhvendosur romë, ashkalinjë dhe egjiptas në pjesën veriore të KosovësShih vendimin e datës 5 qershor 2009 për përshkrimin e plotë të çështjeve të përfshira të të drejtave njerëzore.

- *N.M. dhe të tjerët*, 26/08 (vendimi i datës 5 qershor 2009) – pjesërisht i pranueshëm

Konfiskimi i pajisjeve nga Komisioni i Pavarur për MedieE drejta për gëzim të papenguar të pronës

- *Nexhmedin Spahiu* 02/08 (mendim i pjesshëm i datës 20 mars 2009) – i refuzuar; vërejtje e PSSP-së; i shtyrë për shqyrtim të mëtejme të bazueshmërisë

Kontest i punësimitE drejta në gjykim të drejtë

- *Gani Emini* 17/08 (vendimi i datës 17 prill 2009) – i pranueshëm

Lëndët e Komisionit për kërkesa banesore pronësoreE drejta për gjykim të drejtë – e drejta për mjet të efektshëm ligjor – e drejta për gëzim të papenguar të pronës – ndalimi i diskriminimit

- *D.K.* 53/08 (vendimi datës 27 shkurt 2009) – i papranueshëm
- *Ramadan Demiroviq* 57/08 (vendim i datës 17 prill 2009) – i papranueshëm
- *Ilija Trajković* 35/08 (vendim i datës 17 prill 2009) – i papranueshëm
- *Zlatana Jovanović* 52/08 (vendimi i datës 23 maj 2009) – i papranueshëm
- *Lumturije Voca* 51/08 (vendim i datës 23 maj 2009) – i papranueshëm
- *M.V.* 19/08 (vendim i datës 5 qershor 2009) – i papranueshëm
- *Ramadan Xhema* 01/09 (vendim i datës 5 qershor 2009) – i papranueshëm.

“14,000” lëndët⁴⁶E drejta për gjykim të drejtë – Gëzim i papenguar i pronës – e drejta për mjet të efektshëm ligjor

- *Petko Milogoriq* 38/08 (vendim i datës 22 maj 2009) – pjesërisht i pranueshëm
- *Dragan Gojković* 61/08 (vendim i datës 4 qershor 2008) – pjesërisht i pranueshëm
- *Sllavko Bogiqeviq* 69/08 (vendim i datës 6 qershor 2009) – pjesërisht i pranueshëm
- *Danilo Çukiq* 63/08 (vendim i datës 6 qershor 2009) – pjesërisht i pranueshëm.
- *Milislav Zivaljević* 58/08 (vendim i datës 6 qershor 2009) pjesërisht i pranueshëm

⁴⁶ Duke iu referuar mijëra lëndëve të parashtruara kundër UNMIK-ut, KFOR-it, IPVQ-ve dhe komunave të ndryshme në vitin 2004, për të cilat procedurat janë pezulluar pas letërës së UNMIK-ut drejtuar gjykatave të ndryshme të Kosovës. Atëbotë, kur është dërguar letra, ajo i është referuar “mbi 14 000 lëndëve” të parashtruara. Në fund, kjo shifër ishte më afër 17 000 – 18 000 lëndëve.

- V.Z. 25/08 (vendim i datës 15 korrik 2009) pjesërisht i pranueshëm

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështjet e ndërlidhura me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

E drejta për gjykim të drejtë – e drejta për gëzim të papenguar të pronës – e drejta për mjet të efektshëm ligjor – e drejta për të mos u diskriminuar

- *Rodolub Todoroviq* 33/08 (vendim i datës 17 prill 2009) – pjesërisht i pranueshëm
- *Kabash Krasniqi* 20/08 (vendim i datës 12 shtator 2009) – pjesërisht i pranueshëm
- *Qaush Smajlaj* 23/08 (vendim i datës 12 shtator 2009) – i papranueshëm

7. Praktika gjyqësore e Panelit

76. Paneli vazhdoi të zhvillojë praktikën e vet gjyqësore gjatë pjesës së parë të vitit 2009. Pas shpalljes së Urdhërës administrative të UNMIK-ut nr. 2009/1, Paneli nuk ka mundur të nxjerrë vendime si i tillë, dhe zhvillimi i praktikës gjyqësore të Panelit u pezullua derisa erdhi anëtari i tretë i Panelit.

7.1. Çështjet e pranueshmërisë

7.1.1. Juridiksioni i Panelit

77. Në një rast ku pretendohet se vet Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 ishte diskriminuese kur zbatohet për PZHBV-të të cilët nuk jetonin në Kosovë, meqë ata i obligonte t'i nënshtrohen rregullës prej gjashtë muajsh, Paneli theksoi se ishte në diskrecionin e PSSP-së që të vendosë për skemën rregullative për sistemin e ankesave kundër UNMIK-ut. Kompetencat e Panelit për të shqyrtuar veprimet e UNMIK-ut lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut nuk shtrihen deri në atë shkallë që Panelit t'i mundësojnë të shqyrtojë pajtueshmërinë e bazës së vet ligjore me instrumentet e të drejtave të njeriut. Shih PKDNJ , *Ramadan Demirović*, Lënda nr. 57/08.

7.1.2. Pranueshmëria *ratione temporis*

78. Në rastet kur personi vdes në rrethana që janë të rrezikshme për jetën e njeriut, dhe ankuesi pohon se nuk janë iniciuar hetime nga autoritetet pranë juridiksionit kohor të Panelit, ankesa lidhur me pjesën substanciale të nenit 2 (d.m.th. vdekja e vërtetë) do të jetë kufizuara në kohë (*ratione temporis*). Mirëpo, pohimet për moszbatimin e hetimeve të efektshme për rastet e vdekjeve të tilla mund të konsiderohen shkelje të mundshme të vazhdueshme dhe mund të përfshihen në juridiksionin kohor të Panelit. Shih PKDNJ, *Snežana Zdravković*, Lënda nr. 46/08 dhe PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr 26/08.

79. Në përgjithësi, kur ankuesi argumenton se një shkelje e pretenduar ka vazhduar rregullisht për disa vite, dhe kjo përbën një mënyrë të sjelljes dhe të rrethanave të grumbulluara, kjo mund të jetë shkelje e vazhdueshme e të drejtave të njeriut. Në kontesktin e rastit *N.M dhe të tjerët*, shumë aspekte të ankesës janë të bazuara në efektet kumulative të ekspozimit në plumb për një kohë të tejkzgjatur, për të cilën Paneli theksoi se mund të jetë shkelje e vazhdueshme, varësisht nga natyra e së drejtës

që kërkohet dhe rrethanave faktike të ankuesit individual. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.1.3. Pranueshmëria *ratione personae*

80. Në rastin e *N.M.dhe të tjerët*, dy persona të shënuar në ankesë kanë vdekur para paraqitjes së ankesës. Paneli theksoi se personat e vdekur nuk mund të jenë “viktima”. Ankesat e tilla do të shpallen të papranueshme *ratione personae*. Kjo rregull më së lehti kuptohet në shembullin vijues. Personi i vdekur nuk mund të paraqesë ankesë duke argumentuar se pasuria e tij është marrë në mënyrë të paarsyeshme nga ndonjë autoritet qeveritar. Trashëgimtari ose pronari aktual i pasurisë është personi i duhur për parashtrimin e një padie të tillë.

81. Kjo ndryshon nga situata kur personi i vdekur nuk e paraqet ankesën por familjarët e personit të vdekur ankohen për vdekjen e shkaktuar dhe mungesën e hetimeve për vdekjen e tillë. Në rastet kur personi ankohet për vdekjen e një anëtari të ngushtë të familjes, Paneli konsideron se parashtruesi i ankesës vepron si person që është ndikuar nga vdekja, dhe jo si përfaqësues i personit të vdekur. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

82. Për më tepër, statusi i viktimës nënkupton një shkallë të vuajtjeve të pavullnetshme apo ekspozim i pavullnetshëm i shkeljes së të drejtave të njeriut në fjalë. Nga personat e arsyeshëm pritet që të marrin masa preventive për t’ju shmangur nënshtrimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut kur është e mundshme dhe kur ata janë të vetëdijshëm për rreziqet e mundshme. Nëse ata zgjedhin që veten ta vënë në një shkallë të caktuar të rrezikut, ata duhet të jenë përgjegjës për veprimet e tyre, edhe nëse qëllimi i tyre është i mirë. Në rastin e *N.M. dhe të tjerët*, grupi i ankuesve përfshinte tre pjesëtarë të stafit të tri organizata joqeveritare (OJQ) të cilët kishin shkuar në kampin e PZHBV për të punuar. Paneli theksoi se punëtorët e OJQ-ve ishin të vetëdijshëm për rreziqet potenciale të kontaminimit të pohuar të plumbit në këto kampe, dhe në fakt ishin të angazhuar në ngritjen e vetëdijesimit për këtë çështje. Në rastin e tillë, Paneli konsideroi se punëtorët e OJQ-ve në mënyrë të vullnetshme i ndërmorem rreziqet e të punuarit në kampe dhe nuk mund të konsideroheshin viktima. Prandaj, Paneli i shpalli ankesat e tri punëtorëve të OJQ-ve të papranueshme *ratione personae*. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.1.4. Rregulla për periudhën gjashtëmujore

83. Në rastet kur personi vdes nën kushte që janë të rrezikshme për jetën e njeriut, dhe ankuesi pohon se nuk janë iniciuar hetime nga autoritetet, dhe se kanë kaluar më shumë se gjashtë muaj nga koha kur ka ndodhur vdekja dhe parashtrimi i ankesës pranë Panelit, ankesa lidhur me pjesën substanciale të nenit 2 të KEDNJ (d.m.th. vdekja aktuale) nuk do të jetë e pranueshme duke pasur parasysh rregullën gjashtëmujore. Mirëpo, pohimet për moszbatimin e hetimeve të efektshme për rastet e vdekjeve të tilla mund të konsiderohen shkelje të mundshme të vazhdueshme dhe mund të mos bien ndesh me rregullën gjashtëmujore. Shih PKDNJ, *Snežana Zdravković*, Lënda nr. 46/08 dhe PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

84. Një situatë e zgjatur vazhdon derisa t’i caktohet fundi. Mirëpo, në rrethana të caktuara, një situatë e tillë mund edhe të përfundojë kur ankuesi nuk ka më efekte

negative nga kjo gjendje. Prandaj, sa i përket kufizimit të periudhës gjashtëmujore, data vendimtare për qëllime të llogaritjes mund të jetë fundi i një situate të tillë ose fundi i ekspozimit ndaj një situate të tillë për një person të caktuar. Në rrethana të caktuara, situata mund të vazhdojë edhe pas përfundimit të ekspozimit, varësisht nga natyra e shkeljes. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

85. Në një situatë të ngjashme, Paneli konsideron se mohimi i së drejtës për t'ju qasur gjykatës mund të jetë një shkelje e vazhdueshme. Paneli përcaktoi se e njëjta vlen për rastet e pohimit të mungesës së një mjeti të efektshëm, që vetvetiu mund të ngritet në nivelin e një shkeljeje të vazhdueshme derisa të ofrohet një mjet i tillë, nëse ofrohet. Prandaj, asnjëri nga këto aspekte nuk është në përplasje me rregullën gjashtëmujore në rastin e PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

86. Paneli duhej të jepte përgjigje në pyetjen nëse rregulla për periudhën gjashtëmujore duhej të zbatohet në këto raste për shkak të pohimit të mungesës së njohurive të popullatës për ekzistimin e Panelit, dhe për shkak të intervalit kohor ndërmjet shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 dhe seancës së parë të Panelit në nëntor 2007. Paneli konsideron se mungesa e dijës për ekzistimin e Panelit vetvetiu nuk përbën një “rrethanë të veçantë” që nga Paneli do të kërkonte pezullimin ose ndërprerjen e periudhës gjashtëmujore nga marrja e vendimit të formës së prerë ose aktit që paraqet shkeljen e pohuar të të drejtave të njeriut. Shih PKDNJ, *Ramadan Demirović*, Lënda nr. 57/08.

87. Në një rast tjetër, Paneli duhej të vendoste për dy çështje që kishin të bënin me paraqitjen efektive të dokumentacionit për të vendosur nëse një ankesë ishte parashtruar brenda gjashtë muajsh nga marrja e vendimit të formës së prerë për atë rast. Sipas Panelit, peridha gjashtëmujore nuk fillon domosdoshmërisht të ecë nga data e vërtetë e ngjarjeve që shkaktuan ankesën për të drejtat e njeriut, ose nga data kur autoritetet relevante morën vendimin e formës së prerë. Për të qenë të drejtë me palët, kufizimi i periudhës gjashtëmujore fillon të ecë nga dita kur ankuesi e din apo është dashur të dijë për faktet që shkaktuan shkeljen e pohuar të të drejtave të njeriut ose vendimin e formës së prerë. Shih PKDNJ, *Ramadan Xhema*, Lënda nr. 01/09. Shih gjithashtu paragrafin 69, *sipër..*

7.1.5. Shterimi i mjeteve në dispozicion

88. Në rastet e personave të zhdukur, rastet e vrasjeve, dhe rastet e pohimeve të trajtimit torturues ose mizor, jonjerëzor apo poshtëruar, PSSP-ja shpesh argumenton se, për shkak të vazhdimin të hetimeve, ankuesit nuk i shterin mjetet që i kanë në dispozicion dhe duhet të presin konkludimin e hetimeve. Mirëpo, Paneli konstatoi se, në rastet kur kemi zhdukje apo vrasje që ka ndodhur tetë vite para se të parashtrohet ankesa, çështja e shterimit të mjeteve duhet t'i bashkohet themelësisë së ankesës për t'u shqyrtuar bashkërisht. Shih PKDNJ, *Snežana Zdravković*, Lënda nr. 46/08.

89. Në PKDNJ, *Slavko Bogicević*, Lënda nr. 69/08, ankuesi pohoi se urdhri i Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut (DD) me të cilin u pezullua procedura për rastet e parashtruara në vitin 2004 gjoja se ndaloj ankuesin që të merr vendim të formës së prerë për rastin e tij për dëmin e shkaktuar pasurisë së tij. UNMIK-u argumentoi se rasti ishte i papranueshëm meqë procedura gjyqësore ishte në vazhdim e sipër, dhe kështu ankuesi nuk i kishte shterur mjetet ligjore vendore. Mirëpo,

parashtrësia e UNMIK-ut nuk cekte ndonjë mjet që ankuesi e kishte në dispozicion për të kundërshtuar pezullimin e procedurës ose kohëzgjatjen e saj. Paneli konstatoi se ankesa e ngritur në mbështetje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, Mbrojtja e pasurisë, ishte e papranueshme për shkak të mosshterimit të mjeteve vendore, meqë procedura gjyqësore lidhur me dëmet e pasurisë ishte në vazhdim e sipër. Mirëpo, Paneli gjithashtu konstatoi se ndërhyrja e pohuar për qasjen e ankuesit në gjykatë (për shkak të urdhrin të DD për pezullim të procedurës) si dhe kohëzgjatja e procedurës (që ka zgjatur prej 24 shtatorit 2004 deri tani) mund të paraqesë një shkelje të mundshme të nenit 6 § 1 të KEDNJ që po vazhdon, si dhe të drejtën në një mjet efektiv sipas nenit 13 të KEDNJ. Shih gjithashtu PKDNJ, *Danilo Cukić*, Lënda nr. 63/08, PKDNJ, *Milislav Zivaljević*, Lënda nr. 58/08, dhe PKDNJ, *V.Z.*, Lënda nr. 25/08.

7.1.6. Kundërshtimi lidhur me karakterizimin e Panelit në ligj për faktet e një rasti

90. PSSP-ja e kundërshtoi karakterizimin që bëri Paneli për faktet e paraqitura nga aplikanti në rastin *Zdravković* për ta shqyrtuar ankesën sipas nenit 3 të KEDNJ, e drejta për të qenë i lirë nga tortura, trajtimi jonjerëzor ose poshtërues, dhe se ankuesi nuk mund ta argumentonte rastin sipas neneve tjera të konventave të ndryshme pas paraqitjes së saj fillestare pranë Panelit.

91. PSSP-ja pohoi se Rregullorja e punës së Panelit kërkon që ankesa të paraqesë një deklaratë të përmbledhur të shkeljes së pohuar të instrumenteve të të drejtave të njeriut sipas të cilave ata ankohen. PSSP-ja në veçanti argumentoi se “të gjitha shkeljet e pohuara të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duhet të jenë shkelje të bëra nga aplikanti në kohën e paraqitjes së aplikacionit. Paraqitja e shkeljeve të pohuara shtesë të [KEDNJ] nuk parashihet me [Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12] dhe me rregullar procedurale, që Panelit i lejojnë të kërkojë vetëm ‘informacione faktike dhe komente gjatë shqyrtimit të ankesës.’”

92. Mirëpo, Paneli konstatoi se ankesa fillestare përfshinte informacione faktike të mjaftueshme dhe deklaratë të mjaftueshme të shkeljes së pohuar që paraqiste ankesë sipas nenit 3 të KEDNJ. Për më tepër, Paneli konkludoi se duke marrë në konsideratë juridiksionin e Panelit për të shqyrtuar rrethanat për të cilat është parashtruar ankesë në frymën e instrumenteve të ndryshme të të drejtave të njeriut, të cekura në nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli është i lirë që fakteve të një rasti t’u atribuojë një karakteristikë tjetër në ligj nga ai që e ka dhënë ankuesi. Paneli gjithashtu konkludoi se ai po ashtu duhet të merr parasysh informacionet shtesë që i paraqiten Panelit gjatë shqyrtimit të ankesës kur bëhet karakterizimi i saj. Prandaj, Paneli e refuzoi kundërshtimin e bërë nga PSSP-ja. Shih PKDNJ, *Snežana Zdravković*, Lënda nr. 46/08.

7.1.7. Heqja e lëndëve

93. Paneli vendosi të heqë lëndët nga lista kur ankuesit nuk pohonin shkelje të të drejtave të njeriut ose kishin pushuar ndjekjen e rastit të tyre pasi Paneli u kishte dhënë mundësi të shumta që ankesat e tyre t’i mbështetin me prova. Shih PKDNJ, *Nexhmedin Llumica*, Lënda nr. 18/08, PKDNJ, *Sefedin Alija*, Lënda nr. 21/08 dhe PKDNJ, *Servete Kusari*, Lënda nr. 22/08.

7.2. Çështjet substanciale

7.2.1. Përgjegjësia e UNMIK-ut për veprimet apo mosveprimet e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë

94. Në rastin e PKDNJ, *Nexhmedin Spahiu*, Lënda nr. 02/08, Paneli konstatoi se UNMIK-u ishte përgjegjës për çdo veprim apo mosveprim me të cilin ngarkoheshin IPVQ-të, së paku çdo herë kur veprimet e IPVQ-ve nuk ishin në përputhshmëri me Kornizën Kushtetuese, të paraqitur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9.

7.2.2. E drejta për gjykim të drejtë – Gabimet e pohuara procedurale dhe faktike

95. Paneli theksoi se nuk është tribunal i “shkallës së katërt” dhe si i tillë nuk do të vë në dyshim vendimet e gjykatave përkatëse dhe të tribunaleve, përveç nëse ka dëshmi se ata kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të paarsyeshme gjatë vendosjes për çështjet kontestuese. Shih PKDNJ, *Kabaš Krasnići*, Lënda nr. 20/08.

7.2.3. E drejta për jetë

96. Kur kemi pretendim të shkeljes së nenit 2 të KEDNJ, e drejta për jetë, këto pohime Paneli do t'i vë nën vështrim hetues shumë të kujdesshëm. Paneli konstatoi se pohimi për moszbatimin e hetimeve të efektshme nga ana e autoriteteve për zhdukjen apo vdekjen e personit, i cili u zhduk nën rrethana kërcënuese për jetën, mund të përbëjë shkelje të vazhdueshme të nenit 2 të KEDNJ, edhe kur konstatohet se vrasja, vdekja ose zhdukja nuk është shkaktuar nga ndonjë përfaqësues i qeverisë. Shih PKDNJ, *Snežana Zdravković*, Lënda 46/08 dhe PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.2.4. Trajtimi ose dënimi torturues, jonjerëzor ose poshtërues

97. Paneli theksoi se të afërmit e ngushtë të viktimës vetë mund të jenë viktima të nenit 3 të KEDNJ, varësisht nga reagimet dhe qëndrimi i autoriteteve përkatëse kur ata të mësojnë për situatën. Shih PKDNJ, *Snežana Zdravković*, Lënda nr. 46/08.

7.2.5. E drejta për mjet të efektshëm

98. Ankuesit pohuan se nuk kishin pasur mundësi që ankesat e tyre t'i paraqesin pranë ndonjë organi që kishte kompetenca detyrimi mbi UNMIK-un për shkak të imunitetit ligjor të UNMIK-ut dhe moskoherencës dhe pasigurisë së sistemit ligjor në Kosovë, duke shkelur të drejtën e tyre për mjet të efektshëm sipas nenit 13 të KEDNJ. Paneli theksoi se e drejta për mjet të efektshëm kërkon që autoritetet të vënë në dispozicion mjetet e tilla, që ankuesit i mundësojnë të ngrisë çështjet e të drejtave të njeriut dhe ato çështje të shqyrtohen nga një autoritet i pavarur me kompetenca mjaft të gjëra për rishikim. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.2.6. E drejta për strehim adekuat, për kujdes shëndetësor dhe për standard jetese

99. Paneli ishte gjithashtu i përballur me të drejtat për strehim adekuat, për kujdes shëndetësor dhe për standard jetese sipas një vargu të gjerë të instrumenteve për të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe nenin 25 (1) të DUDNJ (UDHR), nenin 11 të KNDESHK (ICESCR) (standardi i jetesës, ushqimi, veshmbathja dhe strehimi), nenin 12 të KNDESHK (ICESCR) (shëndeti), dhe nenin 5 të KEDR (CERD) (strehimi), nenin 12 të KEDKG (CEDAW) (qasja në kujdesin shëndetësor dhe ushqimin, veçanërisht gjatë shtatzënisë), nenin 14 të KEDKG (CEDAW) (standarde adekuate jetese, duke përfshirë edhe strehimin dhe higjienën publike), nenin 24 të KDF (CRC) (ushqimi, uji) dhe nenin 27 të KDF (CRC) (standard jetese, ushqim, veshmbathje dhe trehim).

100. Në rastin e *N.M. dhe të tjerët*, ankuesit pretenduan se UNMIK-u, me mosndërmarrjen e masave për zhvendosjen e ankuesve nga lokacionet që pohohet se janë të kontaminuara me plumb, dhe me mosndërmarrjen e hapave pozitivë për përmirësimin e shëndetit, strehimit dhe kushteve të jetesës për PZHBV që i ka pasur nën kujdesin e tij, UNMIK-u ka shkelur standardet minimale të të drejtave të njeriut lidhur me strehimin, shëndetin dhe standardet adekuate të jetesës. Paneli konstatoi se pohimet e tilla nuk ishin të pabazuara në shikim të parë duke ditur ekzistimin e mundshëm të obligimeve pozitive dhe të vazhdueshme të palës së paditur lidhur me të drejtat për strehim, shëndet dhe standard adekuat jetese. Paneli gjithashtu theksoi se autoritetet publike, në rrethana të caktuara, mund të bartin përgjegjësinë për sa u përket kushteve të mëvonshme të jetesës së ankuesve, që janë rezultat i reperkusioneve të veprimeve apo mosveprimeve të mëparshme të autoriteteve. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.2.7. Ndalimi i diskriminimit

101. Në rastin e *N.M. dhe të tjerët*, ankuesit pohojnë se komuniteti rom/ashkali/egjiptas i nënshtrohet diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe atij institucional, dhe mosndërmarrja e masave nga UNMIK-u për zhvendosjen e tyre nga kampet e PZHBV që pohohet të jenë të kontaminuara me plumb, është një manifestim tjetër i këtij diskriminimi të ngulitur, veçanërisht në rrethana ku komunitetet tjera të PZHBV-ve gjoja se janë trajtuar në mënyrë më të favorshme dhe janë zhvendosur më shpejt nga lokacionet e rrezikshme. Ata pohojnë se një mënyrë e diskriminimit është manifestuar përmes veprimeve apo mosveprimeve të UNMIK-ut me faktin e moszhvendosjes së tyre në mjedis më të sigurt, dhe me mosfrimin e informacioneve adekuate për rreziqet e shëndetit me të cilat përballen, dhe mosndërmarrjen e hapave për përmirësimin e standardeve të jetesës për disa vite. Paneli konstatoi se këto ankesa me të cilat pohohet diskriminim i drejtpërdrejtë apo institucional nuk ishin të pabazuara në shikim të parë dhe duhej të shqyrtohej themelësia e tyre. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.2.8. Ndalimi i diskriminimit kundër grave

102. Në *N.M. dhe të tjerët*, ankuesit pohuan shkelje të dispozitave specifike të Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas KEDKG (CEDAW), duke përfshirë nenin 2 (dënimi i diskriminimit kundër gruas), nenin 3 (obligimi për ndërmarrjen e veprimeve për garantimin e barazisë), nenin 5 (obligimi për ndërmarrjen e masave lidhur me edukimin familjar në interesin më të mirë të fëmijëve) dhe nenin 12 (obligimi për ndërmarrjen e masave për eliminimin e

diskriminimit kundër grave në fushën e kujdesit shëndetësor dhe sigurimin e shërbimeve adekuate lidhur me shtatzëninë, duke përfshirë shërbimet falas dhe ushqimin adekuat).

103. Ankuesit pretenduan se ata iu nënshtruan rrezikut serioz për jetën dhe shëndetin e tyre nga kontaminimi i pohuar me plumb në kampet dhe nga kushtet e përgjithshme të tmerrshme të kampit. Kjo vazhdoi nga vendosja e tyre fillestare, qëndrimi i tyre afatgjatë në kamp dhe moszhvendosja e ankuesve nga kampet. Kombinimi i pohuar i mungesës së kujdesit shëndetësor adekuat, informacioneve mjekësore, dhe edukimit familjar ishin veçanërisht të rënda për gratë shtatzëna për shkak të rritjes së cenueshmërisë së tyre dhe të fëmijëve të tyre të palindur. Paneli konstatoi se pohimet e tilla nuk ishin të pabazuara në shikim të parë dhe se një pjesë e ankesës duhet të vazhdojë të shqyrtohet nga aspekti i themelësisë së rastit. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.2.9. Të drejtat e fëmijës

104. Ankuesit në *N.M. dhe të tjerët* pohuan se UNMIK-u shkeli nenin 2 të KDF (liria nga diskriminimi), për shkak të diskriminimit të pohuar etnik dhe gjinor, nenin 3 të KDF (interesat më të mira të fëmijës) për pohimin e mosmarrjes parasysh të interesave më të mira të fëmijës, nenin 5 të KDF (të drejtat e prindërve) për pohimin e mosrespektimit të të drejtave të prindërve për gjoja mosraportim të rezultateve të analizave të gjakut apo dhënien e informacioneve të sakta. Për më tepër, ankuesit pohuan se UNMIK-u shkeli nenin 6 të KDF (e drejta për jetë, mbijetesë dhe zhvillim) për ata fëmijë të cilët kanë vdekur apo gjoja u janë mohuar të drejtat e tyre për të mbijetuar apo për t'u zhvilluar, si pasojë e pamjaftueshmërisë mentale të fëmijëve të lindur me helmim të plumbit dhe përmes mohimit të trajtimit mjekësor.

105. Ankuesit gjithashtu pohuan se UNMIK-u nuk krijoi kushte në të cilat një fëmijë me paaftësi mentale apo fizike të mund të gëzojë një jetë të plotë dhe të duhur me kujdes të veçantë, duke shkelur nenin 23 të KDF (të drejtat e fëmijëve me paaftësi mentale apo fizike). Ata gjithashtu pohojnë se UNMIK-u ka shkelur nenin 24 të KDF (e drejta për standardin më të lartë të arritshëm të shëndetit) përmes ndalimit të sigurimit të ushqimit të duhur dhe kujdesit shëndetësor, duke mos marrë parasysh rreziqet e ndotjes ambientale dhe mossigurimit të informacioneve të duhura apo sigurimit të çfarëdo informacioni. Përfundimisht, ankuesit pohojnë shkelje të nenit 27 të KDF (e drejta për standard adekuat jetese, për ushqim, veshmbathje dhe strehim), nenit 37 të KDF (ndalimi i trajtimit mizor, jonjerëzor ose degradues), nenit 16 të KDF (mbrojtja nga sulmet mbi privatësinë apo ndërhyrjen në privatësi, në jetën familjare dhe familjen), dhe nenin 19 të KDF (mbrojtja e fëmijëve nga dhuna fizike apo mentale, lëndimi apo keqpërdorimi) për shkak të kushteve të përgjithshme në kampe.

106. Paneli theksoi se pohimet për shkeljet e të drejtave të sipërpërmendura nuk ishin të pabazuara në shikim të parë dhe nevojitej shqyrtim i themelësisë për secilën ankesë. Shih PKDNJ, *N.M. dhe të tjerët*, Lënda nr. 26/08.

7.2.10. Kufizimet e së drejtës për qasje në gjykatë

107. Në PKDNJ, *Qaush Smajlaj*, Lënda nr. 23/08, ankuesi pohoi se kërkesa që i tërë dokumentacioni dhe lutjet e paraqitura në Dhomën e Posaçme të përkthehen në

gjuhën angleze, e paraparë në nenin 22.7 të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për shfrytëzimin e pasurisë së paluajtshme në pronësi shoqërore, shkeli të drejtën e tij për qasje në gjykatë sipas nenit 6 §1 të KEDNJ. Paneli theksoi se një kufizim që ndikon në të drejtën e qasjes në gjykatë, siç është kërkesa për përkthim ose taksa për paraqitjen e shkresave, nuk është në pajtim me nenin 6 § 1 të KEDNJ, përveç nëse ndjek një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie proporcionale e arsyeshme në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit legjitim që kërkohet të arrihet. Një taksë e tillë, edhe kur është e arsyeshme, prapëseprapë mund të përbëjë shkelje nëse nuk ka ndonjë dispozitë për heqjen e taksës ose dispozita është joadekuate për ankuesit të cilët nuk mund t'i mbulojnë këto shpenzime. Paneli theksoi se kërkesa për përkthim për sa u përket procedurave pranë Dhomës së Posaçme ishte e lidhur me ofrimin e mundësisë për gjyqtarët ndërkombëtarë në Dhomën e Posaçme që të administrojnë drejtësinë pa vonesa. Paneli potencoi se konteksti unik i Kosovës kishte nevojë për gjyqtarë ndërkombëtarë, gjuha e punës e të cilëve ishte anglishtja, për të siguruar administrimin e drejtë të drejtësisë në fusha të caktuara. Duke konstatuar se qëllimi i kufizimit ishte legjitim, Paneli konstatoi se kërkesa që aplikantët të cilët kanë mundësi financiare të përkthejnë dokumentacionin e tyre ligjor ishte në proporcion të arsyeshëm me këtë qëllim. Përfundimisht, meqë Urdhëresa administrative ku përfshiheshin dispozitat e taksave parashihte që shpenzimet të hiqen për palët të cilët dorëzonin dëshmi për vështirësitë e tyre financiare, Paneli konkludoi se të drejtat e ankuesve për qasje në gjykatë nuk ishin shkelur. Më pas Paneli e hudhi poshtë ankesën si të pabazuar. Shih PKDNJ, *Qaush Smajlaj*, Lënda nr. 23/08.

7.2.11. Disriminimi gjuhësor

108. Në rastin *Smajlaj*, ankuesi pohoi se kërkesa për të siguruar përkthime në gjuhën angleze të dokumentacionit të përpiluar në gjuhën shqipe ose serbe diskriminonte folësit shqiptarë dhe serbë në favor të folësve anglez. Mirëpo, Paneli theksoi se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/46 mbi përdorimin e gjuhëve në procedurat gjyqësore ku merr pjesë një gjyqtar apo prokuror ndërkombëtar, iu mundësoi palëve që gjykatës t'i drejtohen në gjuhën e tyre. Sa u përket parashtrësve me shkrim të paraqitura në Dhomën e Posaçme, Paneli theksoi se kufizimet e tilla lidhur me qasjen tanimë i konsideronte se në mënyrë të arsyeshme janë të lidhura me qëllimin legjitim në kontekstin e administrimit ndërkombëtar të Kosovës, dhe se siguronte garancione adekuate për heqjen e shpenzimeve për personat të cilët nuk mund të paguanin për përkthimet. Kështu, Paneli konstatoi se ky aspekt i ankesës ishte i pabazuar. Shih PKDNJ, *Qaush Smajlaj*, Lënda nr. 23/08.

7.2.12. E drejta për paraqitjen e ankesës në procedurë civile

109. Paneli konstatoi se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2008/4 e datës 5 shkurt 2008 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, duke dhënë të drejtën për të paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Dhomës së Posaçme, akoma nuk kishte hyrë në fuqi as në kohën e aktgjykimit as në kohën kur në fakt ishte paraqitur ankesa. UNMIK-u e kishte shtyrë hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje disa herë në pritje të rikonfigurimit të UNMIK-ut. Meqë e drejta për të paraqitur ankesë nuk ekzistonte sipas ligjit në kohën përkatëse, Paneli theksoi

se ankuesit nuk i ishte mohuar një e drejtë e tillë. Paneli gjithashtu theksoi se në çështjet civile, nuk ekziston ndonjë e drejtë e pranuar për paraqitjen e ankesës (siç ekziston në çështjet penale). Shih PKDNJ, *Kabaš Krasnići*, Lënda nr. 20/08.

7.2.13. E drejta për gëzim të papenguar të pronës

110. Lidhur me pohimet e ankuesit sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, Paneli theksoi se mbrojtja sipas kësaj dispozite vlen vetëm për pronat aktuale. Derisa në rrethana të caktuara të paturit e “një pritjeje legjitime” për fitimin e një pasurie mund të gëzojë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, ky nen nuk zbatohet për situata ku ekziston një kontest për sa i përket aplikimit dhe interpretimit të ligjeve vendore, dhe ku parashtrësat e ankuesit më pas janë refuzuar nga gjykatat. Shih PKDNJ, *Kabaš Krasnići*, Lënda nr. 20/08.

Shtojcat

Shtojca A: Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, më 23 mars 2006

Shtojca B: Urdhëresa administrative e UNMIK-ut nr. 2009/1, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, e datsë 17 tetor 2009

Shtojca C: Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, Rregullorja e Punës, Rregulla 29*bis* (miratuar më 11 shtator) dhe Rregulla 39*bis* (miratuar më 30 nëntor 2009)

Shtojca D: Grafiku i rrjedhës së lëndëve pranë Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut

Annex A: UNMIK RREGULLORE No. 2006/12

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au
Kosovo

UNMIK/REG/2006/12
23 mars 2006

RREGULLORE NR. 2006/12

MBI THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLDHËNËS PËR TË DREJTAT E
NJERIUT

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke pasur parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të themelimit të Panelit këshilldhënës për të drejtat e njeriut, si organ i përkohshëm gjatë mandatit të UNMIK-ut, për shqyrtimin e shkeljeve të supozuara të të drejtave të njeriut nga ana e UNMIK-ut,

Me anë të kësaj shpall Rregulloren në vijim:

KAPITULLI I: Themelimi dhe kompetencat e Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 1

Themelimi i Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

1.1 Me këtë themelohet Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut (Paneli këshilldhënës)

1.2 Paneli këshilldhënës shqyrton ankesat e çdo personi apo grupit të personave të cilët pohojnë se janë viktimë të shkeljes së të drejtave të njeriut nga UNMIK-u sikur që është dhënë në njërin apo në më shumë instrumentet vijuese:

(a) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e datës 10 dhjetor 1948;

2

(b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut të datës 4 nëntor 1950 bashkë me Protokollin e saj;

(c) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike e datës 16 dhjetor 1966 bashkë me Protokollin e saj;

(d) Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore e datës 16 dhjetor 1966;

(e) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor e datës 21 dhjetor 1965;

(f) Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave e datës 17 dhjetor 1979;

(g) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese e datës 17 dhjetor 1984 dhe

(h) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve e datës 20 dhjetor 1989.

1.3 Pas përfundimit të shqyrtimit të një ankese, Paneli këshilldhënës ia dërgon konkluzionet e veta Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Konkluzionet e Panelit këshilldhënës, të cilat mund të përfshijnë rekomandime janë të natyrës këshilldhënëse.

Neni 2

Kompetencat e përkohshme dhe territoriale

Paneli këshilldhënës ka kompetenca në gjithë territorin e Kosovës dhe për ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e supozuara të të drejtave të njeriut që janë bërë pas datës 23 prill 2005 apo që kanë rrjedh nga faktet e paraqitura para kësaj date dhe që këto fakte rrisin në vazhdimësi shkeljen e të drejtave njerëzore.

Neni 3

Kriteret për pranimin e ankesës

3.1 Paneli këshilldhënës mund të trajtojë një çështje vetëm pasi të ketë konkluduar se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera të mundshme për shqyrtimin e shkeljes së supozuar dhe brenda një periudhe prej gjashtë (6) muajsh nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë.

3.2 Paneli këshilldhënës nuk shqyrton ankesën që është:

(a) anonime ose

3

(b) kryesisht e njëjtë me një çështje që tanimë është shqyrtuar nga Paneli këshilldhënës dhe nuk përmban informata të reja përkatëse.

3.3 Paneli këshilldhënës shpall si të papranueshme çdo ankesë të cilën e konsideron se nuk është në përputhshmëri me të drejtat e njeriut, të përcaktuara në një apo në më shumë instrumente të përmendura në nenin 1.2 lart dhe e konsideron si të pabazë ose shpërdorim i së drejtës së ankesës.

KAPITULLI 2: Përbërja dhe statusi i Paneli këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut

Neni 4

Selia dhe përbërja

4.1 Paneli këshilldhënës e ka selinë në Prishtinë.

4.2 Paneli këshilldhënës përbëhet prej tre anëtarëve nga të cilët njëri emërohet kryesues. Së paku një anëtar i Panelit këshilldhënës duhet të jetë femër.

4.3 Anëtarët e Panelit këshilldhënës janë juristë ndërkombëtarë me karakter të lartë moral, paanshmëri dhe integritet, të dëshmuar si ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, në veçanti në sistemin evropian.

Neni 5 Emërimi i anëtarëve

5.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm emëron anëtarët e Panelit këshilldhënës pas propozimit të bërë nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

5.2 Anëtarët emërohen me mandat dy (2) vjeçar. Emërimi mund të vazhdohet edhe për një mandat tjetër dyvjeçar (2).

Neni 6 Dhënia e betimit solemn

Me rastin e emërimit, çdo anëtar i Panelit këshilldhënës e nënshkruan deklaratën në vijim para Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm ose para personit të caktuar nga ai:

“Solemnisht deklaroj se:

“Do t’i përmbahem ligjit gjatë gjithë kohës së ushtrimit të funksioneve në postin tim dhe do të veproj në pajtim me standardet më të larta profesionale e respektin më të lartë ndaj dinjitetit të postit tim dhe detyrave që më janë besuar.

4

Në ushtrimin e funksioneve të postit tim gjithmonë do të mbështes standardet më të larta të pranura ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, përfshirë ato të paraqitura në parimet e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike bashkë me Protokollet e saj, në Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, në Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave, në Konventën kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore apo Degraduese dhe në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve”.

Neni 7 Imuniteti dhe pacenueshmëria

7.1 Zyrat e shfrytëzuara nga Paneli këshilldhënës janë të pacenueshme. Arkivi, lëndët, dokumentet, komunikimet, prona, fondet dhe pasuritë e Panelit këshilldhënës kudo që të vendosen dhe nga kushdo që të mbahen janë të pacenueshme dhe të mbrojtura nga bastisja, marrja, sekuestrimi, konfiskimi, shpronësimi ose nga çfarëdo forme tjetër e ndërhyrjes përmes veprimit ekzekutiv, administrativ, gjyqësor a legjislativ.

7.2 Anëtarët e Panelit këshilldhënës kanë imunitet të njëjtë si personeli i UNMIK-ut sipas neneve 3.3 dhe 3.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

7.3 Sekretari i Përgjithshëm ka të drejtë dhe përgjegjësi t’ia heqë imunitetin e anëtarit të Panelit këshilldhënës në çdo rast që, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengojë rrjedhat e drejtësisë dhe ai mund të hiqet pa cenuar interesat e UNMIK-ut.

Neni 8
Burimet financiare dhe njerëzore

Për funksionimin efikas të Panelit këshilldhënës merren masat e duhura përmes sigurimit të burimeve të nevojshme financiare dhe njerëzore.

Neni 9
Sekretariati

Panelit këshilldhënës ka sekretariatit me orar të plotë.
KAPITULLI 3: Procedura e punës së Panelit këshilldhënës mbi të drejtat e njeriut
Neni 10

Parashtrimi i ankesave dhe përfaqësuesit sipas detyrës zyrtare

5

10.1 Ankesat i parashtrohen Panelit këshilldhënës në formë të shkruar.

10.2 Ankesa mund të parashtrohet nga ankuesi ose në emër të tij nga anëtari i familjes, nga organizata joqeveritare ose nga sindikata.

10.3 Në mungesë të parashtrimit të ankesës sipas nenit 10.2, Paneli këshilldhënës mund të emërojë një person të përshtatshëm përfaqësues sipas detyrës zyrtare për të parashtruar ankesën dhe për të vepruar në emër të viktimës ose viktimave të dyshuara në procedurën e përcaktuar në këtë kapitull nëse Paneli këshilldhënës ka informacione të besueshme se është bërë shkelje e të drejtave të njeriut.

10.4 Me kërkesën e përfaqësuesit të caktuar sipas detyrës zyrtare, Paneli këshilldhënës mund të përfundojë procedurën sipas nenit 10.3 nëse viktimat ose viktimat e dyshuara nuk dëshirojnë që të vazhdojë procedura ose nëse vazhdimi i procedurës nuk është me interes publik për ndonjë person tjetër.

10.5 Për parashtrimin e ankesës nuk parashihet kurrfarë pagese.

Neni 11
Parashtrësat me shkrim

11.1 Ankesa paraqet të gjitha faktet e rëndësishme mbi të cilat bazohet shkelja e supozuar e të drejtave të njeriut. Ankesës mund t'i bashkëngjiten edhe dokumente të tjera si dëshmi.

11.2 Pas marrjes së ankesës Paneli këshilldhënës përcakton se a është ankesa e pranueshme. Nëse informacionet e dhëna me ankesën nuk mundësojnë që të bëhet një konstatim i tillë, Paneli këshilldhënës kërkon informacione shtesë nga ankuesi. Nëse Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e papranueshme, ai merr vendim me të cilin refuzohet ankesa.

11.3 Kur Paneli këshilldhënës konstaton se ankesa është e pranueshme, ai ia referon ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm në mënyrë që të merret një përgjigje në emër të UNMIK-ut lidhur me ankesën. Përgjigja e tillë i jepet Panelit këshilldhënës brenda njëzet (20) ditësh nga dita e pranimin të ankesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

11.4 Paneli mund të kërkojë nga ankuesi dhe UNMIK-u që të bëjnë parashtresa tjera me shkrim brenda afateve kohore që ai mund t'i caktojë nëse këto parashtresa janë në interes të drejtësisë.

Neni 12

Fshehtësia e komunikimeve

6

12.1 Komunikimet ndërmjet Panelit këshilldhënës dhe ankuesit ose personit që vepron në emër të tij janë të fshehta.

12.2 Fshehtësia e komunikimit siç paraqitet në nenin 12.1 zbatohet në tërësi kur ankuesi ose personi që vepron në emër të tij është në paraburgim.

Neni 13

Pjesëmarrja e një Amicus Curiae dhe e avokatit të popullit

13.1 Paneli këshilldhënës, kur është në interes të drejtësisë, mund të ftojë

(a) Një amicus curiae që të parashtrorë komentet me shkrim dhe

(b) Avokatin e popullit që të parashtrorë komentet me shkrim nëse ai është duke u marrë me këtë çështje.

13.2 Parashtresat me shkrim nga avokati i popullit do të jenë pa paragjykime mbi autorizimet, përgjegjësitë dhe obligimet e avokatit të popullit sipas ligjit në fuqi.

Neni 14

Seancat verbale

Kur është në interes të drejtësisë Paneli këshilldhënës mban seanca verbale.

Neni 15

Kërkesat për paraqitjen e personave ose për parashtrimin e dokumenteve

15.1 Paneli këshilldhënës mund të kërkojë paraqitjen e çdo personi, përfshirë edhe personelin e UNMIK-ut, ose parashtrimin e çdo dokumenti, përfshirë dosjet dhe dokumentet që i posedon UNMIK-u, të cilat mund të jenë të rëndësishme për ankesën.

15.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm bashkëpunon me Panelin këshilldhënës dhe i ofron atij ndihmën e nevojshme gjatë ushtrimit të pushtetit dhe kompetencave të tij në mënyrë të vaçantë për lëshimin e dokumenteve dhe informatave që janë të rëndësishme për ankesën..

15.3 Kërkesat për paraqitjen e personelit të UNMIK-ut ose për parashtrimin e dokumenteve të Kombeve të Bashkuara i bëhen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm. Gjatë marrjes së vendimit për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm merr parasysh interesin e drejtësisë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe interesat e përgjithshme të UNMIK-ut e të Kombeve të Bashkuara.

7

Neni 16

Seancat publike dhe qasja në dokumentet e deponuara në Panelin këshilldhënës

16.1 Seancat e Panelit këshilldhënës janë publike përveç në rastet e jashtëzakonshme kur Paneli këshilldhënës vendos ndryshe.

16.2 Pas miratimit nga Paneli këshilldhënës, dokumentet e deponuara në Panelin këshilldhënës për të drejtat e njeriut mund t'i vëhen në dispozicion çdo personi që ka interes të ligjshëm në çështjen pas paraqitjes së kërkesës me shkrim.

Neni 17

Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshilldhënës

17.1 Paneli këshilldhënës sjell konkludimet mbi atë se a ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut dhe, kur është e nevojshme, bën rekomandime. Këto konkludime dhe çdo rekomandim i Panelit këshilldhënës i parashtrohen Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm.

17.2 Konkludimet dhe rekomandimet e Panelit këshilldhënës botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjërë dhe qasje në to.

17.3 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm ushtron pushtetin dhe diskrecionin ekskluziv për të vendosur se a duhet vepruar sipas konkludimeve të Panelit këshilldhënës.

17.4 Vendimet e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm botohen me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në mënyrën që siguron shpërndarje të gjërë dhe qasje në to.

Neni 18

Rregullorja e punës

18.1 Paneli këshilldhënës miraton rregulloren e punës për procedurat e veta. Rregullorja e punës mund t'i jepë autorizime dhe përgjegjësi sekretariatit të Panelit këshilldhënës.

18.2 Pas miratimit nga Paneli këshilldhënës, rregullorja e punës publikohet me kohë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe me qëllim të shpërndarjes së gjërë dhe qasjes në to.

8

KAPITULLI 4: Dispozitat përfundimtare

Neni 19
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të shpallë çdo udhëzim të nevojshëm administrativ për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 20
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 21
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 23 mars 2006, përveç nenit 10 i cili hyn në fuqi me 23 prill 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Annex B: UNMIK URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK

UNMIK/DIR/2009/1
17 tetor 2009

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2009/1

**PËR IMPLEMENTIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UR NR. 2006/12 MBI
THEMELIMIN E PANELIT KËSHILLËDHËNËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP),

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me nenin 19 të Rregullores nr. 2006/12 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 23 mars 2006 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/3, të datës 12 janar 2007 (Rregullorja),

Duke marrë parasysh Rregulloren e Punës të miratuar më 5 shkurt 2008 nga Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, në pajtim me nenin 18 të Rregullores,

Me qëllim të qartësimit të karakterit dhe rregullimit të procedurave të dëgjimeve publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, shqyrtimin e pranueshmërisë së ankesave nga ky Panel dhe caktimin e një afati kohor për paraqitjen e ankesave pranë këtij Paneli, Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, duke pasur parasysh kapacitetin e zvogëluar të UNMIK-ut që të ushtrojë autoritet ekzekutiv në mënyrë efektive në të gjitha fushat nga ku burojnë çështjet e ankesave për të drejtat e njeriut,

Me anë të kësaj nxjerr këtë Urdhëresë administrative,

Neni 1
Dëgjimet publike

1.1 Dëgjimet publike të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (Paneli Këshillëdhënës) do të drejtohen në mënyrën dhe përbërjen që qartazi do të lënë të kuptohet se janë procedura joadversiale dhe që do t'ju përcillen të gjithë pjesëmarrësve si dhe opinionit të gjerë publik, duke përfshirë edhe mediat e pranishme, nëse prania e tyre lejohet nga Paneli Këshillëdhënës.

1.2 Gjatë dëgjimeve publike, ankuesve apo përfaqësuesve të tyre do t'ju lejohet të bëjnë deklarata duke përmbledhur pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut, ashtu siç është paraqitur në parashtrësën me shkrim pranë Panelit Këshillëdhënës. Gjatë dëgjimeve publike, Paneli Këshillëdhënës mund t'ju parashtrojë pyetje palëve ose përfaqësuesve të tyre të cilat qartësojnë bazën faktike të ankesës, dhe që për Panelin Këshillëdhënës janë të nevojshme që në tërësi të vlerësojë pohimin për shkeljen e të drejtave të njeriut të paraqitur pranë tij.

1.3 Vendi dhe rregullimi i ulëseve për dëgjimet publike të drejtuara nga Paneli Këshillëdhënës janë në përputhje me natyrën joadversiale të procedurës.

Neni 2

Çështjet e pranueshmërisë

2.1 Në cilëndo fazë të procedurës së një ankese mbi të drejtat e njeriut të paraqitur pranë tij, Paneli Këshillëdhënës shqyrton të gjitha çështjet e pranueshmërisë së ankesës para se të shqyrtojë bazueshmërinë e rastit.

2.2 Çdo ankesë e cila është apo mund të jetë në të ardhmen çështje e procesit të ankesave të palës së tretë ose procedurave sipas nenit 7 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2000/47 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë, të datës 18 gusht 2000, do të konsiderohet e papranueshme për arsye se procesi i ankesave të palës së tretë të KB-së dhe procedura sipas nenit 7 të Rregullores nr. 2000/47 janë mjete në dispozicion sipas nenit 3.1 të Rregullores.

2.3 Komentet mbi bazueshmërinë e një shkeljeje të pohuar të të drejtave të njeriut paraqiten vetëm pasi Paneli Këshillëdhënës të ketë përfunduar shqyrtimin për rastin dhe të ketë vendosur për pranueshmërinë e ankesës së tillë. Nëse ndonjë çështje për pranueshmërinë e një ankese paraqitet në cilëndo kohë pasi që Paneli Këshillëdhënës të ketë marrë vendimin mbi pranueshmërinë e ankesës dhe të ketë filluar shqyrtimin për bazueshmërinë, Paneli Këshillëdhënës e pezullon shqyrtimin mbi bazueshmërinë derisa pranueshmëria e ankesës të rivlerësohet plotësisht dhe për atë të vendoset përsëri.

2.4 Pas çdo vendimi të ri mbi pranueshmërinë e rastit, Paneli Këshillëdhënës vendimin e tillë të ri ia referon Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm me qëllim të marrjes së komenteve shtesë për ankesën.

Neni 3

Emërimi dhe dorëheqja e anëtarëve të Panelit

3.1 Kryetari i Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut do të propozojë një numër të mjaftueshëm të kandidatëve të përshtatshëm për emërim sipas nenit 5 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2006/12, në pajtim me rregullat e zbatueshme të prokurimit të KB-së, pas marrjes së kërkesës nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Nëse UNMIK-u nuk merr asnjë propozim apo merr numër

të pamjaftueshëm të propozimeve brenda një muaji kalendarik nga kërkesa e tillë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të bëjë emërimin e nevojshëm pa propozimin e kërkuar dhe pas konsultimeve me organet relevante ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut.

3.2 Nëse një apo më shumë anëtarë të Panelit Këshillëdhënës japin dorëheqje nga postet e tyre, Paneli nuk merr asnjë vendim derisa të bëhen emërimet e reja duke ia mundësuar Panelit të arrijë numrin e parashikuar të anëtarëve.

Neni 4

Publikimet e Panelit Këshillëdhënës

Të gjitha publikimet, njoftimet dhe komunikatat për shtyp të Panelit Këshillëdhënës bëhen përmes zyrës së zëdhënësit të UNMIK-ut dhe informimit publik, që e ndihmon Panelin Këshillëdhënës në njoftimet e tij zyrtare mbi të gjitha çështjet.

Neni 5

Data e prerë për parashtrimin e ankesave

Pavarësisht nga neni 3.1 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, asnjë ankesë dorëzuar Panelit Këshillëdhënës nuk do të jetë e pranueshme nëse pranohet nga Sekretariati i Panelit Këshillëdhënës më vonë se 31 mars 2010.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 17 tetor 2009 dhe është e zbatueshme për të gjitha ankesat e dorëzuara Panelit Këshillëdhënës, duke përfshirë edhe ato të cilat janë në pritje për t'u shqyrtuar nga Paneli Këshillëdhënës.

Lamberto Zannier

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Annex C: Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, Rregullorja e Punës, Rregulla 29bis dhe Rregulla 39bis

Rregulla 29bis (miratuar më 11 shtator)

Rregulla 29bis. Vendimi për pranim pa ia komunikuar ankesën UNMIK-ut

Paneli mund gjithashtu të deklarojë menjëherë se ankesa është e pranueshme, kur në ankesë ngriten çështje që në esencë janë të njëjta sikurse ato të ngritura në ankesa të tjera, të cilat tanimë janë shpallur të pranueshme nga Paneli, dhe kur nuk ngriten çështje të reja të pranueshmërisë.

Rregulla 39bis (miratuar më 30 nëntor 2009)

Rregulla 39bis. Kërkesat për kufizime në zbulimin e dëshmive

1. Çilado palë mund të kërkojë nga Paneli të mos i zbulojë palës tjetër në procedurë dëshmitë që i ka paraqitur ajo, për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik ose për të mbrojtur të drejtat fundamentale të ankuesit apo të ndonjë personi tjetër në fjalë. Cilado kërkesë e tillë do të përfshijë arsyet dhe do të specifikojë nëse kërkon kufizimin e zbulimit të tërë informacionit të paraqitur apo vetëm një pjese të tij. Paneli vendos për kërkesën në bazë të njëjës palë (*ex parte*).

2. Nëse Paneli e miraton kërkesën, ai e njofton palën tjetër për vendimin e tij dhe vepron në përputhje me rrethanat. Për aq sa nuk e rrezikon karakterin konfidencial të informacionit të pranuar, Paneli tregon llojin e dëshmive të pranuar në fshehtësi. Paneli ka mundësi që vendimet e veta t'i bazoj në dëshmi të pranuar në fshehtësi.

Nëse Paneli nuk e miraton kërkesën, ose nëse e miraton vetëm pjesërisht, palën kërkuese e njofton për vendimin e tij, dhe asaj i jep mundësinë që të rishqyrtojë çështjen e parashtrimit të dëshmive pranë Panelit.

Annex D: The Human Rights Advisory Panel Case Flow Chart

